



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.140

14 tetor

2011

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.681, datë 5.10.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”	6299
Vendim i KM nr.686, datë 5.10.2011	Për një ndryshim në vendimin nr.922, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, që prodhohet, ruhet, përpunohet, apo transmetohet në sistemet e komunikimit (INFOSEC).....	6299
Vendim i KM nr.690, datë 5.10.2011	Për miratimin e rregullores “Për mbrojtjen kriptografike të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””.....	6300
Urdhër i MPPT nr.86, datë 12.9.2011	Për disa ndryshime në rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për punët publike”, miratuar me urdhrin nr.84, datë 8.9.2006 të ministrit, të ndryshuar.....	6309
Vendim i GJL nr.2, datë 24.1.2011	Akuzuar: Për kryerjen e veprës penale “Trafikim i lëndëve narkotike, në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal.....	6311
Vendim i GJL nr.8, datë 10.6.2011	Objekti i padisë: Konstatimi i zgjidhjes së marrëdhënies së punës me shkak abuziv, detyrimi i punëdhënësit të dëmshpërblejë paditësen me pagën e një viti pune për shkak të zgjidhjes së kontratës për shkak abuziv; konstatim i zgjidhjes për shkak të paarsyeshëm dhe detyrimi për të dëmshpërblyer me pagën e një viti pune; pagimi i dy muajve pagë për mosrespektim të procedurës dhe pagimi i pushimeve të papaguara.....	6324

VENDIM
Nr.681, datë 5.10.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.545, DATË 11.8.2011 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË
KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS,
ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE/KRYEMINISTRIT,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E
PREFEKTIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 18 e 29 të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”, të nenit 4/2 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 4/2 e vendimit nr.545, datë 11.8.2011 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4/2. Në Kryeministri, pozicionet “Drejtor i Departamentit të Legjislacionit dhe Koordinimit”, “Drejtor i Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit” dhe “Drejtor i Departamentit të Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj”, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë; pozicionet “Jurist në Departamentin e Legjislacionit dhe Koordinimit”, “Koordinator pranë sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave”, “Inspektor në Departamentin e Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsionit” dhe “Koordinator në Departamentin e Bashkërendimit të Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj”, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2011, të përballohen nga fondet e planifikuara për Kryeministrinë, po për vitin 2011.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.686, datë 5.10.2011

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.922, DATË 19.12.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SIGURIMIN E INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET
SHTETËROR”, QË PRODHOHET, RUHET, PËRPUNOHET APO TRANSMETOHET NË
SISTEMET E KOMUNIKIMIT (INFOSEC)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25 e 31 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun II, shkronja “E” “Sigurimi i komunikimeve”, të vendimit nr.922, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave, fjalët “..., strukturë në varësi të Shërbimit Informativ të Shtetit, ...”, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.690, datë 5.10.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR MBROJTJEN KRIPTOGRAFIKE TË
INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25 e 31 të ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror””, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore “Për mbrojtjen kriptografike të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror””, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr.14, datë 28.1.2002 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullore “Për shërbimin shifrar të Republikës së Shqipërisë””, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
**PËR MBROJTJEN KRIPTOGRAFIKE TË INFORMACIONIT TË KLASIFIKUAR “SEKRET
SHTETËROR”**

KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Objekti i këtij vendimi është përcaktimi i strukturave kriptografike, detyrat që ato kryejnë dhe rregullat që zbatohen për sigurimin kriptografik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” në institucionet shtetërore të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2

Mbështetja ligjore

1. Ligji nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.922, datë 17.12.2007 “Për sigurimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” që prodhohet, ruhet, përpunohet apo transmetohet në sistemet e komunikimit”.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.121, datë 15.3.2001 “Për rregullat e sigurimit fizik të informacionit të klasifikuar”, i ndryshuar.

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.122, datë 15.3.2001 “Për shqyrtimin e pastërtisë dhe për dhënien e “Certifikatës së sigurisë” personave që do të njihen me informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””, i ndryshuar.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.81, datë 28.1.2008 "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave për asgjësimin e informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror"

Neni 3 Elementet e sigurisë

1. "Siguria kriptografike" është aplikimi i masave të sigurisë ndaj informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror", që qarkullon në kanalet e komunikimit masiv dhe publik, me qëllim mbrojtjen nga persona të paautorizuar.

2. Parimi "Nevojë për njohje" është parimi, sipas të cilit njohja me sistemet kriptografike lejohe vetëm për personelin e autorizuar dhe të pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme.

3. "Përgjegjësi individuale" do të thotë që çdo përdorues përgjigjet për sigurimin dhe kontrollin e materialit kriptografik që ka në administrim. Përdoruesi që ka të drejtën e njohjes dhe përdorimit të materialit kriptografik trajnohet dhe praktikohet. Përdoruesit e autorizuar për njohjen e sistemeve kriptografike nuk duhet të shpërndajnë informacionin kriptografik te persona të tjerë të paautorizuar.

Neni 4 Përkufizime

Për efekt të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

1. "Kriptografi" është praktika e sigurimit të konfidencialitetit, integritetit, autenticitetit, disponibilitetit të informacionit të klasifikuar nëpërmjet kriptimit dhe dekriptimit të tij.

2. "Material kriptografik" përfshin çelësat në të gjitha format e tyre, dokumentet, pajisjet që përmbajnë informacion kriptografik e që janë të rëndësishëm për kriptimin dhe dekriptimin e informacionit.

3. "Kriptim" është procesi i transformimit të informacionit në mënyrë të tillë që të fsheh përmbajtjen e tij.

4. "Dekriptim" është procesi i kundërt i kriptimit.

5. "Mbrojtja kriptografike" është aplikimi i metodave dhe mjeteve kriptografike për fshehjen e përmbajtjes së informacionit.

6. "Çelës kriptografik" është variabël transformimi, i cili përdoret gjatë kriptimit-dekriptimit të informacionit.

7. "Algoritëm kriptografik" është metodë që mundëson kriptimin dhe dekriptimin e informacionit.

8. "Pajisje kriptografike" nënkupton pajisje teknike ose software (program) që përdoren për mbrojtjen kriptografike të informacionit.

9. "Sisteme kriptografike" nënkupton tërësinë e pajisjeve kriptografike dhe materialeve kriptografike të përdorura si një njësi e vetme për të realizuar procesin kriptografik sipas rregullave përkatëse për administrimin e tyre.

10. "Incident kriptografik" konsiderohet çdo veprim ose mosveprim që cenon sigurinë e sistemeve kriptografike, komprometimin e procesit kriptografik dhe leximin e informacionit të klasifikuar.

11. "Komprometim i informacionit" nënkupton vënien në dispozicion në mënyrë të qëllimshme ose jo të materialit kriptografik, personave të paautorizuar, si rrjedhojë e humbjes, vjedhjes, spiunazhit, rikuperimit, defekteve të materialit kriptografik, shikimit, fotografimit etj., dhe që cenon konfidencialitetin, disponibilitetin dhe integritetin e informacionit të klasifikuar. Çdo rast komprometimi trajtohet si incident kriptografik.

12. "Përdorues të pajisjeve kriptografike" janë punonjësit që për kryerjen e detyrave të tyre kërkojnë akses në materialet kriptografike dhe kryejnë proceset kriptografike të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror".

KREU II STRUKTURAT KRIPTOGRAFIKE

Neni 5

Strukturat kriptografike të përcaktuara dhe të specializuara realizojnë sigurinë kriptografike.

Neni 6

Autoriteti i mbrojtjes kriptografike

Drejtoria e Shifrës, strukturë në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes, është Autoritet Kombëtar për Sigurimin e Komunikimeve dhe Autoritet Kombëtar i Shpërndarjes.

Neni 7

Strukturat kriptografike qendrore

1. Strukturat kriptografike qendrore janë struktura bazë për mbrojtjen kriptografike të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, në çdo institucion qendror shtetëror.
2. Strukturat kriptografike qendrore ngrihen në Ministrinë e Mbrojtjes, në Ministrinë e Brendshme, në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe në Shërbimin Informativ të Shtetit.
3. Çdo institucion tjetër ngre strukturat e veta kriptografike për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kur e gjykon të nevojshme.
4. Struktura kriptografike qendrore ka varësi funksionale nga titullari i institucionit.

Neni 8

Zyrat/sectorët kriptografikë

1. Zyra/sectori kriptografik përbën njësinë më të vogël kriptografike dhe kryen përpunimin kriptografik të informacionit të klasifikuar që njësi strukturore shkëmben me struktura të tjera shtetërore.
2. Zyra/sectori kriptografik i ngritur pranë njësi strukturore ka varësi administrative dhe profesionale:
 - a) Varësia administrative është nga drejtuesi i njësisë strukturore, në përbërje të të cilit vepron sectori kriptografik;
 - b) Varësia profesionale është nga titullari i strukturës qendrore kriptografike të institucionit dhe përfshin: mënyrën e kryerjes së procesit kriptografik, furnizimit me materiale kriptografike, shmangien e defekteve dhe raportimin e incidenteve, asgjësimin dhe shkatërrimin e materialit kriptografik.
3. Kur zyra/sectori kriptografik mbyllet, i gjithë dokumentacioni i krijuar gjatë dhe në funksion të aktivitetit të saj/tij asgjësohet dhe shkatërrohet sipas legjislacionit në fuqi.
4. Aktiviteti kriptografik i këtyre strukturave kriptografike qendrore, zyrave/sectorëve kriptografikë kryhet në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.

KREU III DETYRAT E STRUKTURAVE KRIPTOGRAFIKE

Neni 9

Drejtoria e Shifrës

Drejtoria e Shifrës, nëpërmjet strukturave të specializuara të saj, kryen këto detyra:

1. Prodhon, siguron dhe aplikon pajisje kriptografike, fortësia e të cilave të jetë në përputhje me nivelin e klasifikimit të informacionit.
2. Siguron që materiali çelës kriptografik të jetë në çdo kohë në kushte pune;
3. Kryen instalimin e pajisjeve kriptografike dhe kontrollon përdorimin e tyre për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, kur ky informacion transmetohet me mjete të komunikimit masiv e publik.

4. Përgatit dokumentacionin e nevojshëm për certifikimin e pajisjeve kriptografike, e paraqet atë në DSIK dhe e përditëson sa herë ka ndryshime të rëndësishme në sistemin kriptografik.
5. Koordinon dhe kontrollon aktivitetin e strukturave kriptografike në institucionet shtetërore.
6. Zbaton kushtet e sigurisë fizike për përdorimin e pajisjeve kriptografike dhe verifikon plotësimin e këtyre kushteve para instalimit të tyre.
7. Përgatit udhëzues të veçantë për përdorimin e çdo pajisjeje kriptografike dhe e vë atë në dispozicion të përdoruesve.
8. Prodhon, administron dhe shpërndan çelësat kriptografikë që përdoren për kriptimin/dekriptimin e informacionit nga strukturat kriptografike, në përputhje me kërkesat e kësaj rregulloreje.
9. Përcakton rregullat e shkatërrimit të materialit çelës kriptografik ose të pajisjeve kriptografike në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi për shkatërrimin e informacionit të klasifikuar.
10. Kryen hapjen dhe mbylljen e zyrave/sectorëve kriptografikë, me kërkesë të institucionit të interesuar, në bashkëpunim me strukturën kriptografike qendrore.
11. Trajnon përdoruesit e pajisjeve kriptografike, në fushën e operimit dhe të shfrytëzimit, në sistemet përkatëse, dhe veçanërisht për veprimet që cenojnë sigurinë e tyre.
12. Pajis me dëshmi aftësie personelin e strukturës kriptografike qendrore dhe të zyrave/sectorëve kriptografikë.
13. Inspekton mënyrën e përdorimit të pajisjeve kriptografike, në çdo institucion, jo më pak se një herë në vit.
14. Harton procedura që duhen ndjekur nga zyrat/sectorët kriptografikë dhe nga struktura kriptografike qendrore, për trajtimin e incidenteve dhe rastet emergjente.
15. Ngre grup pune për hetimin e shkaqeve e rrethanave në rast incidentesh kriptografike dhe merr masat përkatëse për shmangien e pasojave negative.
16. Administron pajisjet kriptografike të certifikuara më parë nga DSIK-ja.

Neni 10

Detyrat e Strukturës Kriptografike Qendrore

Struktura Kriptografike Qendrore ka këto detyra:

1. Bashkëpunon me Drejtorinë e Shifrës dhe DSIK-në për projektimin dhe krijimin e infrastrukturës së nevojshme për ngritjen e sistemit/sistemeve kriptografike të institucionit.
2. Merr në dorëzim sistemin/sistemet kriptografik të ngritur dhe ndjek respektimin e standarteve të sigurisë gjatë përdorimit të tij.
3. Ndjek respektimin e procedurave kriptografike të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror” nga përdoruesit e strukturave kriptografike të institucionit.
4. Merr masa për pajisjen e përdoruesve me certifikatë sigurie të përshtatshme.
5. Merr masa për certifikimin e pajisjeve kriptografike që përdor institucioni.
6. Merr masa për respektimin e afateve të ndryshimit të çelësve kriptografikë të përcaktuara në procedurat e operimit të sigurt.
7. Kontrollon mënyrën e marrjes, ruajtjes dhe përdorimit të çelësve kriptografikë, në strukturat kriptografike në varësi.
8. Kryen teste periodike të pajisjeve kriptografike në përdorim të institucionit ku operon.
9. Koordinon punën me Drejtorinë e Shifrës, për trajnimin e përdoruesve të sistemit/sistemeve kriptografike.
10. Ndjek detyrat në kuadrin e planit të evakuimit të informacionit të klasifikuar në rastet e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile në lidhje me materialet kriptografike të strukturave kriptografike të institucionit.
11. Mbikëqyr punën e përdoruesve të pajisjeve kriptografike, evidenton dobësitë që shfaqen gjatë procesit kriptografik dhe rekomandon masat për korrigjimin e tyre.
12. Raporton incidentet menjëherë te titullari i institucionit, Drejtoria e Shifrës dhe DSIK-ja.
13. Mban një regjistër qendror për pajisjet kriptografike që institucioni ka në përdorim, kryen për çdo vit inventarin e tyre dhe njofton Drejtorinë e Shifrës mbi rezultatin e tij.

14. Mban aktдорëzimin e materialit kriptografik kur puna është e organizuar me turne, nga dorëzuesi te marrësi në dorëzim. Modeli i aktдорëzimit përcaktohet nga Drejtoria e Shifrës.

Neni 11

Përdoruesi i pajisjeve kriptografike

1. Përdoruesi i pajisjeve kriptografike të plotësojë këto kushte:
 - a) Të njohë legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”.
 - b) Të jetë pajisur me certifikatë sigurie të përshtatshme.
 - c) Të jetë instruktuar dhe pajisur me dëshmi aftësie të përshtatshme në fushën e kriptografisë, për njohjen e pajisjes kriptografike në përdorim.
2. Përdoruesi i pajisjeve kriptografike ka për detyrë:
 - a) Të përdorë pajisjet kriptografike sipas konfigurimit strukturor dhe në përputhje me nivelin e klasifikimit të informacionit.
 - b) Të kryejë sipas procedurave të përcaktuara, kriptimin, dekriptimin, transmetimin dhe evidentimin e informacionit të klasifikuar.
 - c) Të konfirmojë në çdo rast mbërritjen e informacionit të kriptuar tek i adresuari.
 - d) Të administrojë informacionin që kripton dhe dekripton, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
 - e) Të informojë me shkrim eprorin për çdo rast komprometimi apo incidenti kriptografik.
 - f) Të dokumentojë kalimin e procesit kriptografik të përdoruesit pasardhës.
3. Përdoruesit të pajisjeve kriptografike i ndalohej:
 - a) Të ndryshojë konfigurimin e pajisjes kriptografike.
 - b) Të krijojë kopje të çelësve kriptografikë në përdorim.
 - c) Të njohë informacionin që nuk është përpunuar nga ai vetë.
 - d) T’u japë personave të paautorizuar, të dhëna mbi procesin kriptografik dhe informacionet e klasifikuara.
 - e) Të zbatojë urdhra që bien në kundërshtim me këtë rregullore.
 - f) Të përdorë pajisje kriptografike të paakredituara më parë nga DSIK-ja.
4. Kur një përdorues i pajisjes kriptografike mungon për një periudhë kohe (leje, sëmundje), ai zëvendësohet nga një përdorues i një strukture apo sektori tjetër me vendndodhje në të njëjtin rajon, i instruktuar dhe certifikuar përshtatshmërisht. Në këtë rast dorëzohen me procesverbal vetëm materialet që nevojiten për punë. Dorëzimi i këtyre materialeve bëhet në prani të eprorit të tij.
5. Kur punonjësi i strukturës kriptografike përgjegjëse transferohet, ai i dorëzon dokumentet pasardhësit.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SISTEMEVE KRIPTOGRAFIKE

Neni 12

Ngritja e sistemit kriptografik

1. Ngritja e sistemit kriptografik nis me kërkesën me shkrim të institucionit të interesuar në Drejtorinë e Shifrës.
2. Drejtoria e Shifrës, në bazë të kërkesës së bërë, vlerëson plotësimin e kushteve të nevojshme dhe kryen instalimin e sistemit kriptografik.
3. Pas instalimit të sistemit kriptografik, Drejtoria e Shifrës kryen testimin e tij.
4. Instalimi i pajisjes kriptografike shoqërohet me aktin e instalimit, i cili mbahet në dy kopje, një për strukturën qendrore dhe një për Drejtorinë e Shifrës. Në aktin e instalimit evidentohen:
 - a) sistemi i instaluar, vendi dhe koha e instalimit;
 - b) niveli i klasifikimit të informacionit që sistemi mbron;
 - c) përdoruesi i sistemit kriptografik dhe instruktimi i tij;
 - ç) çelësat kriptografikë të instaluar.
5. Administrimi i sistemit kriptografik kryhet nga struktura kriptografike qendrore e institucionit.

6. Drejtuesi i strukturës kriptografike qendrore, sektorit/zyrës kriptografike është përgjegjës për sigurinë e sistemit kriptografik të institucionit dhe administrimin e dokumentacionit në përdorim.

Neni 13

Pajisjet kriptografike

1. Drejtoria e Shifrës vendos në përdorim pajisjet kriptografike, pasi të jenë certifikuar nga DSIK-ja.
2. Pajisjet kriptografike përdoren deri në nivelin e klasifikimit të informacionit, për të cilin janë certifikuar dhe sipas instruksioneve të përdorimit të tyre.
3. Pajisjet kriptografike ruhen, në mënyrë të tillë që të ndalohej aksesimi i paautorizuar në këto pajisje.
4. Pajisjet kriptografike transportohen të ndara nga çelësat kriptografikë.
5. Çelësat kriptografikë futen në përdorim vetëm pasi verifikohet paprekshmëria e tyre.
6. Në rast se dyshohet për komprometimin e çelësve, ata nuk futen në përdorim dhe për këtë njoftohet Drejtoria e Shifrës.
7. Drejtoria e Shifrës në rast defekti, merr masa për riparimin e pajisjes kriptografike.
8. Kur kryhet riparimi i pajisjes kriptografike, drejtuesi i strukturës kriptografike qendrore merr masa për mosekspozimin e përmbajtjes së informacionit të klasifikuar.
9. Instalimi apo heqja nga përdorimi i pajisjeve kriptografike kryhet në çdo rast nga persona të instruktuar dhe të autorizuar posaçërisht.
10. Drejtoria e Shifrës, sipas një plani të hartuar më parë, kryen testime periodike të sistemeve kriptografike në përdorim për funksionimin e tyre.

Neni 14

Nxjerrja nga përdorimi të pajisjes kriptografike

Pajisjet kriptografike nxirren jashtë përdorimit kur:

1. nuk janë në gjendje të sigurojnë mbrojtjen e informacionit të klasifikuar në nivelin e kërkuar ose kur konstatohet komprometimi i tyre;
 2. përdorimi i tyre nuk është më i domosdoshëm.
- Nxjerrja nga përdorimi i pajisjeve kriptografike shoqërohet gjithmonë me procesverbal.

Neni 15

Prodhimi, ruajtja dhe shkatërrimi i çelësve kriptografikë

1. Çelësat kriptografikë të prodhuar kanë elementet e identifikimit të tyre dhe nivelin e sigurisë së informacionit që mbrojnë.
2. Çelësat kriptografikë shpërndahen në mënyrë të sigurt. Gjatë transportit ruhet paprekshmëria e çelësve kriptografikë e konfirmuar me procesverbal nga marrësi/përdoruesi i tyre.
3. Marrësi në dorëzim i çelësve kriptografikë mban procesverbalin përkatës në rast se konstaton parregullsi.
4. Ndryshimi i çelësve kriptografikë bëhet sipas afateve të përdorimit të tyre, të përcaktuara në procedurat e operimit të sigurt.
5. Ndalohet krijimi i kopjeve të paautorizuara dhe të padokumentuara, të çelësve kriptografikë.
6. Shkatërrimi i çelësve kriptografikë kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e Drejtorisë së Shifrës.
7. Për shkatërrimin e çelësve kriptografikë mbahet një procesverbal në dy kopje, një për sektorin që kryen shkatërrimin dhe një kopje për strukturën kriptografike qendrore. Kur shkatërrimi i çelësve kriptografikë bëhet nga struktura kriptografike qendrore, ky procesverbal bëhet në një kopje.
8. Drejtoria e Shifrës inspekton jo më pak se një herë në vit strukturat kriptografike qendrore dhe sektorët kriptografikë, për përdorimin, ruajtjen dhe shkatërrimin e çelësve kriptografikë.

Procedurat e shpërndarjes së materialit kriptografik

1. Shpërndarja e materialit kriptografik kryhet në ministri dhe institucione shtetërore të interesuara brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore jashtë vendit.

2. Përgatitja e pakove me material kriptografik

a) Materiali çelës kriptografik pakëtohet i ndarë nga pajisja shoqëruese kriptografike dhe transportohet si pjesë e të njëjtës ngarkesë.

b) Pajisja kriptografike të jetë në gjendjen fillestare para transportimit, përjashtuar rastet kur konfigurimi fizik i tyre e bën të pamundur fshirjen.

c) Pajisja kriptografike klasifikohet në nivelin e çelësit kriptografik dhe mbështjellja e brendshme duhet të identifikojë përmbajtjen si “kriptografike”.

d) Korrieri plotëson raportin e transportimit të materialit kriptografik për çdo ngarkesë në dy kopje. Një kopje e këtij raporti vendoset brenda kutisë së çdo ngarkese dhe një kopje mbahet nga institucioni dërgues.

e) Materiali kriptografik mbyllet me dy mbështjellëse të zeza dhe jotransparente, të vulosura. Materiali kriptografik i mbështjellë vendoset brenda një çante të posaçme ose kutie të kyçur dhe të vulosur që eliminon ekspozimin e përmbajtjes.

f) Materiali kriptografik do të ketë dy mbështjellëse me cilësitë e mëposhtme:

i) Mbështjellësja e brendshme me ngjyrë të zezë. Në të shënohet adresa e dërguesit, adresa e marrësit, niveli i klasifikimit, i shoqëruar me shenjzimin “Kriptografik” dhe instruksionin “të hapet vetëm nga ... (emri dhe mbiemri i marrësit)”.

ii) Mbështjellësja e jashtme, me ngjyrë të zezë. Në të shënohet adresa e dërguesit, adresa e marrësit dhe numri i regjistrimit. Ndalohet vendosja e shenjzimeve të tjera mbi këtë mbështjellëse.

g) Përpara marrjes në dorëzim të pakos verifikohet rregullsia e shenjzimeve të përcaktuara me sipër. Kur konstatohen parregullsi rasti konsiderohet incident dhe do të trajtohet sipas nenit 20 të kësaj rregulloreje.

3. Transportimi i materialit kriptografik

a) Korrierët e Drejtorisë së Shifrës kryejnë transportimin e sigurt të materialit kriptografik në përputhje me nivelin e klasifikimit të këtij materiali.

b) Materialet kriptografike sigurohen në të gjitha fazat e transportimit të tij, përgjatë itinerarit të përcaktuar nga Drejtoria e Shifrës.

c) Dërguesi i materialit kriptografik merr nga marrësi një raport të firmosur ose mesazh elektronik për çdo ngarkesë të dërguar. Nëse nuk merret kopje e nënshkruar brenda 10 ditësh, dërguesi e ndjek çështjen e pakos së dërguar derisa të konfirmohet marrja.

4. Instruksione për korrierët

a) Autoritetet doganore dhe të sigurisë ekzaminonë pakot me material kriptografik pa i hapur ato.

b) Për transportimin e pakove me material kriptografik që nuk mbahen me vete, korrierët marrin masa që të shohin ngarkimin dhe shkarkimin e sigurt të tyre sipas parimit “i fundit në hyrje - i pari në dalje”.

c) Korrierët duhet të sigurohen që materiali ka mbrojtjen maksimale gjatë të gjitha fazave të transportit të tij.

d) Korrierët nuk ngarkohen me detyra të tjera gjatë udhëtimit për transportimin e materialit kriptografik. Nëse i caktohen detyra të tjera, ato duhet të jenë dytësore dhe të mos cenojnë në asnjë mënyrë detyrat dhe përgjegjësitë e korrierit.

e) Korrierët duhet të jenë të instruktuar për mënyrat e mbrojtjes së vazhdueshme të materialit kriptografik që u besohet.

KREU V
AMBIENTET DHE MJEDISËT KRIPTOGRAFIKE

Neni 17

Kërkesa për sigurimin fizik të ambienteve dhe mjediseve kriptografike

1. Ambientet dhe mjediset kriptografike duhet të plotësojnë kërkesat e legjislacionit, për sigurimin fizik të informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”.
2. Ambientet dhe mjediset kriptografike vendosen në zona sigurie të klasit të dytë.
3. Ambientet dhe mjediset e kriptografike pajisen me kasaforta të nivelit “tepër sekret”, për ruajtjen e informacionit të klasifikuar, çelësve kriptografikë ose pajisjeve kriptografike.
4. Procesi kriptografik kryhet vetëm në sisteme të certifikuara. Ndalohet lidhja e pajisjeve kriptografike në internet, në rrjete të pacertifikuara apo rrjete me nivel certifikimi më të ulët se niveli i certifikimit të pajisjes kriptografike. Për përdorimin e tyre përgatiten udhëzues të veçantë nga Drejtoria e Shifrës.
5. Ambientet dhe mjediset kriptografike u nënshtrohen jo më pak se një herë në vit inspektimeve dhe kontrolleve për respektimin e kërkesave të sigurisë.

Neni 18

Kërkesat për evakuim

1. Titullarët e institucioneve, që administrojnë informacion të klasifikuar, përcaktojnë dhe marrin masa për rregullat dhe procedurat e evakuimit të pajisjeve kriptografike dhe të informacionit të klasifikuar, në rastet e gjendjes së luftës, të gjendjes së jashtëzakonshme, gjendjes së fatkeqësive natyrore dhe emergjencave të tjera civile, gjatë të cilave ky informacion mund të përvetësohet, dëmtohet, shkatërrohet apo asgjësohet.
2. Përdorimi i pajisjeve kriptografike në kushte e emergjencave, bëhet me urdhër të drejtuesit të njësisë strukturore ku përdoruesi bën pjesë. Në këto raste përdoruesit i sigurohet minimumi i kushteve të sigurisë, në përputhje me nivelin e klasifikimit të pajisjes kriptografike.

KREU VI
INCIDENTET DHE MASAT PËRKATËSE

Neni 19

Incident kriptografik

Incidente kriptografike konsiderohen:

1. Humbja e materialit kriptografik;
2. Komprometimi, humbja apo kopjimi nga persona të paautorizuar i çelësve kriptografikë;
3. Përdorimi i pajisjes kriptografike pa u certifikuar me parë nga DSIK-ja;
4. Përdorimi i pajisjes kriptografike nga persona të paautorizuar;
5. Ruajtja ose përdorimi i pajisjes kriptografike jashtë kërkesave të sigurisë fizike;
6. Transmetimi i informacionit të klasifikuar me pajisje kriptografike me nivel klasifikimi më të ulët se niveli i klasifikimit të sistemit/pajisjes kriptografike;
7. Transmetimi i informacionit të klasifikuar me pajisje kriptografike të dëmtuara;
8. Administrimi në kundërshtim me rregullat e përcaktuara i materialeve kriptografike;
9. Keqfunksionimi i pajisjes kriptografike;
10. Modifikim i paautorizuar i materialit kriptografik;
11. Mospërdorimi i materialeve kriptografike.

Neni 20

Masat për incidentet kriptografike

1. Në rast incidenti kriptografik, menjëherë pas konstatimit, ndërpritet procesi i kriptim-dekriptimit me çelësat kriptografikë në përdorim dhe vihet në dijeni me shkrim struktura kriptografike qendrore.

2. Struktura kriptografike qendrore merr masa për shmangien ose kufizimin e pasojave negative dhe informon brenda 24 orëve Drejtorinë e Shifrës.

3. Për sqarimin e rrethanave të incidentit ngrihet një komision, me urdhër të përbashkët të dy institucioneve, në përbërje të të cilit bëjnë pjesë specialistë nga Drejtoria e Shifrës, nga struktura kriptografike qendrore dhe sektori kriptografik ku ka ndodhur incidenti.

4. Konkluzionet e komisionit hartohen në tri kopje, një për sektorin kriptografik ku ka ndodhur incidenti, një për strukturën kriptografike qendrore dhe një për Drejtorinë e Shifrës.

5. Për konkluzionet e nxjerra nga komisioni për incidentin e ndodhur, Drejtoria e Shifrës njofton DSIK-në.

6. Përfundimet që dalin nga analiza e incidentit trajtohen gjatë procesit të trajnimit dhe edukimit të përdoruesve.

KREU VII PËRGATITJA DHE INSPEKTIMET

Neni 21 **Përgatitja**

1. Përgatitja kriptografike kryhet sipas një plani të veçantë të hartuar nga Drejtoria e Shifrës dhe të miratuar nga titullari institucionit.

2. Përgatitja mbi përdorimin e pajisjeve kriptografike kryhet sa herë futen në përdorim pajisje të reja me qëllim përdorimin korrekt të tyre.

3. Drejtoria e Shifrës miraton programet dhe temat e trajnimit.

4. Përgatitja kryhet nga Drejtoria e Shifrës.

5. Përgatitja kriptografike shoqërohet me dhënie të dëshmisë së aftësisë, me afat vlefshmërie deri në 5 vjet.

Neni 22 **Inspektimet**

1. Inspektimet bëhen në funksion të zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe kritereve të përcaktuara në këtë rregullore.

2. Inspektimet për çdo institucion kryhen nga Drejtoria e Shifrës, jo më pak se një herë në vit me autorizim të titullarit të institucionit. Inspektime bën edhe drejtuesi i strukturës kriptografike qendrore, në sektorët kriptografikë vartës.

3. Pas çdo inspektimi, përpilohet raporti i inspektimit në tri kopje, një për drejtuesin e institucionit, një për strukturën kriptografike qendrore të inspektuar dhe një për Drejtorinë e Shifrës.

4. Drejtoria e Shifrës raporton periodikisht, por jo më pak se një herë në gjashtë muaj, në DSIK për inspektimet e kryera.

KREU VIII DOKUMENTACIONI

Neni 23 **Regjistrat**

1. Strukturat kriptografike pajisen me regjistra ku evidentohet procesi kriptografik që kryhet.

2. Regjistrat për evidentimin e procesit kriptografik hartohen nga Drejtoria e Shifrës dhe miratohen nga DSIK-ja.

3. Për nevoja pune strukturat kriptografike përdorin këto regjistra të klasifikuar:

a) Regjistri bazë (model 1), ku regjistrohen të gjitha regjistrat e strukturës.

b) Regjistri ku regjistrohen të gjitha pajisjet kriptografike dhe dokumentacioni përkatës (model 2).

c) Regjistri i mesazheve të hyra (model 3).

- d) Regjistri i mesazheve të dala (model 4).
- e) Regjistri i korrespondencës (model 5).

Neni 24

Administrimi i dokumentacionit dhe i materialit kriptografik

Dokumentacioni dhe materialet kriptografike të përdorura me qëllim zbatimin e kësaj rregulloreje, administrohen sipas legjislacionit në fuqi për informacionin e klasifikuar.

KREU IX

BUXHETI I AUTORITETIT TË MBROJTJES KRIPTOGRAFIKE

Neni 25

1. Drejtorisë së Shifrës i akordohen fonde buxhetore brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.
2. Ky buxhet përdoret për:
 - a) prodhimin dhe blerjen e pajisjeve kriptografike;
 - b) instalimin e pajisjeve kriptografike;
 - c) shpërndarjen e çelësave;
 - d) trajnimin/përgatitjen e përdoruesve;
 - e) kontrollin e procesit kriptografik;
 - f) inspektimet.

KREU X

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26

1. Moszbatimi i kërkesave të kësaj rregulloreje përbën shkelje të rregullave të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe sjell sipas rastit, përgjegjësi disiplinore, administrative ose penale.
2. Ngarkohen institucionet shtetërore që kanë të ngritura struktura kriptografike për zbatimin e kësaj rregulloreje.
3. Ngarkohet Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) dhe Drejtoria e Shifrës për ndjekjen e zbatimit të kësaj rregulloreje.
4. Rregullorja e miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.14, datë 28.1.2002, për "Miratimin e rregullores për shërbimin shifrar të Republikës së Shqipërisë" shfuqizohet.

URDHËR

Nr.86, datë 12.9.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E DHËNIES SË LICENCAVE PROFESIONALE PËR PUNËT PUBLIKE", MIRATUAR ME URDHËRIN NR.84, DATË 8.9.2006 TË MINISTRIT, TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.412, datë 15.9.1992 "Për krijimin e komisionit të posaçëm për dhënien e licencave profesionale", të ndryshuar, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.613, datë 13.12.1993 "Për ushtrimin e veprimtarisë në ndërtim dhe projektim të shoqërive", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Në rregulloren "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për punët publike", të miratuar me urdhrin nr.84, datë 8.9.2006 të Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe

Telekomunikacionit, të ndryshuar me urdhrat: 83, datë 3.6.2008, nr.116, datë 31.7.2008, nr.71, datë 7.5.2009 nr.147, datë 7.12.2009 dhe nr.71 datë 4.5.2010, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

2. Në lidhjen nr.2 “Klasifikimi dhe kategoritë e punimeve të projektimit”, shtohet paragrafi:

“13. STUDIME E PROJEKTIME TË NDËRTIMIT DHE MBYLLJES SË VENDDEPOZITIMEVE TË MBETJEVE TË NGURTA (URBANE) (vetëm për shoqëri/subjekte juridike).

3. Në lidhjen nr.5 “Kushte dhe kriteret për të përfituar klasa dhe kategori të projektimit nga persona fizikë dhe shoqëritë”, pas paragrafit “12. STUDIME TË SIZMOLOGJISË INXHINIERIKE (vetëm për shoqëri/subjekte juridike)” shtohet paragrafi:

“13. STUDIME E PROJEKTIME TË NDËRTIMIT DHE MBYLLJES SË VENDDEPOZITIMEVE TË MBETJEVE TË NGURTA (URBANE) (vetëm për shoqëri/ subjekte juridike).

Këtë kategori e përfitojnë shoqëritë/subjektet juridike që kanë të regjistruar për drejtues teknik të paktën dy specialistë të lartë, të cilët:

- duhet të kenë jo më pak se 5 (pesë) vjet eksperiencë profesionale në këtë fushë;
- një specialist duhet të këtë diplomë universitare të integruar ose diplomë të nivelit të dytë në “Inxhinieri mjedisi” ose “Kimi teknologjike” (për këtë të fundit të jenë diplomuar përpara vitit 1985);
- një specialist duhet të këtë diplomë universitare të integruar ose diplomë të nivelit të dytë në degët e inxhinierisë së ndërtimit: Inxhinieri ndërtimi ose hidroteknik.

4. Në kreun V “DOKUMENTET QË SHOQËROJNË KËRKESËN PËR LICENCË PROFESIONALE”, në nenin 31, pas pikës “B” shtohen pikat:

C. “Për rinovimin e kategorive të licencës individuale të mbikëqyrjes e kolaudimit”.

Kërkesa për rinovimin e kategorive shoqërohet me:

- CV profesionale;
- kopje të kartës së identitetit;
- mandatin e kryerjes së pagesës prej 1 (një) euro.

D. “Për rinovimin e kategorive të licencës së shoqërisë për mbikëqyrje e kolaudim”.

Kërkesa për rinovimin e kategorive shoqërohet me:

- CV-në profesionale të shoqërisë;
- kopje të ekstraktit të QKR-së;
- mandatin e kryerjes së pagesës prej 1 (një) euro.

E. Në kreun VIII “DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT”, në nenin 40, pas pikës “6” shtohet pika “6/1” me këtë përmbajtje:

“Subjektet fizike dhe juridike që disponojnë licenca profesionale për ushtrim aktiviteti në fushën e mbikëqyrjes e kolaudimit sipas kategorive të mëparshme (jo sipas kategorive të miratuara me këtë urdhër), duhet të paraqiten për rinovimin e tyre 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri. Mbas këtij afati licencat do të konsiderohen të pavlefshme.”

F. Lidhja nr.4 ndryshon si më poshtë:

“TABELA E KATEGORIVE TË MBIKËQYRJES DHE KOLAUDIMIT TË PUNIMEVE TË ZBATIMIT NË NDËRTIM”

I. PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

NP-1 Punime gjurmimi në tokë.

NP-2 Ndërtime civile dhe industriale.

NP-3 Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

NP-4 Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tranvai, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale.

NP-5 Punime nëntokësore, ura e vepra arti.

NP-6 Diga dhe tunele hidroteknike.

NP-7 Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.

NP-8 Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë.

NP-9 Punime dhe mbrojtje lumore, sistemime hidraulike dhe bonifikime.

NP-10 Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.

NP-11 Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve, linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.

NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit.

II. PUNIME SPECIALE NDËRTIMI

NS-1 Punime për prishjen e ndërtimeve.

NS-2 Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanderi, mirëmbajtja e tyre.

NS-3 Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).

NS-4 Punime rifiniturë të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.

NS-5 Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut.

NS-6 Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.

NS-7 Barriera dhe mbrojtje rrugore.

NS-8 Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.

NS-9 Punime strukturore speciale.

NS-10 Shtresa dhe mbistruktura speciale.

NS-11. Punime mbi shina dhe traversa.

NS-12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit.

NS-13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.

NS-14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.

NS-15 Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore.

NS-16 Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij.

NS-17 Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.

NS-18 Punime topogjeodezike.

NS-19 Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë.

NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

VENDIM

Nr.2, datë 24.1.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Shpresa Beçaj Kryesuese

Ardian Dvorani Anëtar

Gani Dizdari Anëtar

Besnik Imeraj Anëtar

Fatos Lulo Anëtar

Ardian Nuni Anëtar

Aleksandër Muskaj Anëtar

Andi Çeliku Anëtar

Arjana Fullani Anëtare

Evelina Qirjako Anëtare

Guxim Zenelaj Anëtar

Majlinda Andrea Anëtare

Mirela Fana Anëtare,

në seancën gjyqësore të datës 17.1.2011 dhe 24.1.2011 morën në shqyrtim çështjen penale nr.5 Akti, që u përket:

TË PANDEHURVE: 1. Lodoviko Salis, i biri i Mikeles dhe i Karmelas, i datëlindjes 1976, me arsim të mesëm, gjendje civile beqar, hetuar dhe gjykuar me masë sigurimi “arrest në burg”.

2. Olsi Leka, i biri i Bashkimit dhe i Aleksandrës, i datëlindjes 21.12.1976, lindur dhe banues në Tiranë, beqar, i padënuar, hetuar dhe gjykuar në gjendje “arresti në burg”.

3. Enton Leka, i biri i Bashkimit dhe i Aleksandrës, i datëlindjes 27.4.1973, lindur në Tiranë, beqar, i padënuar, hetuar e gjykuar në gjendje “arresti në burg.

AKUZUAR: Për kryerjen e veprës penale “Trafikim i lëndëve narkotike, në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 283/a, paragrafi i dytë i Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 283/a i Kodit Penal.

Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.47, datë 12.12.2006, ka vendosur:

1. Deklarimin fajtor të të pandehurit Lodoviko Mikele Salis për kryerjen e veprës penale të “trafikimit të lëndës narkotike” në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 282/a /2 e 22 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Lodoviko Mikele Salis fillon nga data 29.12.2004 dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.

2. Deklarimin fajtor të të pandehurit Enton Bashkim Leka për kryerjen e veprës penale të “trafikimit të lëndës narkotike” në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 të 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 11 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Enton Bashkim Leka fillon nga data e ndalimit të tij dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.

3. Deklarimin fajtor të të pandehurit Olsi Bashkim Leka për kryerjen e veprës penale të “trafikimit të lëndës narkotike” në bashkëpunim, mbetur në tentativë, parashikuar nga neni 283/a/2 e 22 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 10 vjet burgim.

Vuajtja e dënimit për të pandehurin Olsi Bashkim Leka fillon nga data 9.3.2005 dhe do të kryhet në burg të sigurisë së zakonshme.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, me vendimin nr.8, datë 15.2.2007, ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr.47, datë 12.12.2006 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

Kundër vendimit nr.8, datë 15.2.2007 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, brenda afatit ligjor, në mbështetje të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale, kanë ushtruar rekurs të të gjykuarit Enton Leka, mbrojtësi i tij, dhe Olsi Leka, duke kërkuar prishjen e vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rigjykim, për këto shkaqe:

- Vendimet janë marrë në mosrespektim të ligjit penal, si dhe duke lejuar shkelje procedurale që sjellin si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimeve të gjykatës, parashikuar nga neni 128 i Kodit të Procedurës Penale.

- Gjykimi i çështjes në Gjykatën për Krimet e Rënda Tiranë është bërë nga dy gjyqtarë që nuk plotësojnë kushtet për të qenë të tillë. Gjyqtarët Mirela Balili dhe Ilirjana Olldashi janë caktuar anëtare të trupit gjykues në kundërshtim me nenin 15 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, jo me short, por me urdhër të kryetarit të gjykatës.

Gjyqtarja Mirela Balili është caktuar në përbërje të trupit gjykues me urdhër, kurse gjyqtarja Ilirjana Olldashi nuk rezulton të jetë caktuar në përbërjen e trupit gjykues me ndonjë akt të veçantë, pra jo me short.

- Praktika e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, me vendimet nr.64, datë 14.2.2007, dhe nr.769, datë 20.12.2006, i ka konsideruar vendimet e marra nga trupat gjykues, ku anëtarët e tij nuk i plotësonin kushtet për të qenë të tillë, si vendime absolutisht të pavlefshme.

- Ankimet e bëra në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda nuk i janë komunikuar avokatit të caktuar me prokurë për të gjykuarin Enton Leka, në kundërshtim me sa parashtron neni 414 dhe 441 i Kodit të Procedurës Penale.

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.s’ka, datë 19.11.2008, ka vendosur:

Kalimin e çështjes penale me të pandehur Lodoviko Salis, Enton Leka e Olsi Leka, në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për njësimin e praktikës gjyqësore.

Me këtë vendim Kolegji Penal shtron për diskutim çështjet si më poshtë:

1. A mund të zgjerohen rastet e papajtueshmërisë në funksionin e gjyqtarit në gjykim, veç atyre që parashikohen në nenet 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale?

2. Mungesa e paanshmërisë së gjyqtarit në gjykimin e një çështjeje konkrete duhet t'i nënshtrohet procesit të të provuarit, apo vetëm të pretendohet? Pra në rastin e zëvendësimit të gjyqtarit/ve të trupit gjykues, që është duke gjykuar një çështje konkrete, mungesa e paanshmërisë është e prezumuar, apo duhet t'i nënshtrohet provës?

3. Shorti, në nenin 9 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", parashikohet si mënyrë e ndarjes së çështjeve gjyqësore, a duhet të shtrihet, si formë organizimi, edhe në caktimin e gjyqtarëve të trupit gjykues që do të gjykojnë secilin prej tyre?

4. Shorti, si masë organizative (e cila parashikohet në një ligj organik), a duhet të konsiderohet rregull i barasvlefshëm me rregullat procedurale që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale, mosrespektimi i të cilave passjell pasoja në kuptimin e procesit të rregullt ligjor?

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Ardian Nuni dhe Gani Dizdari; prokurorin Artur Selmani, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë; mbrojtësin e të gjykuarve Olsi Leka dhe Enton Leka, avokatin Vladimir Meçe, që kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe atij të Gjykatës për Krimet e Rënda Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën për Krimet e Rënda Tiranë, me tjetër trup gjykues; pasi shqyrtuan dhe analizuan në tërësi çështjen,

VËREJNË:

I. Rrethanat e faktit

1. Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga aktet e dosjes gjyqësore dhe vendimet e dhëna nga dy gjykatat më të ulëta, u rezultojnë të pranuarat prej tyre rrethanat si vijon:

Nga materialet e çështjes rezulton se më datën 28.12.2004, gjatë kontrollit fizik të ushtruar në pikën e kalimit kufitar të Portit të Durrësit, është kryer kontrolli fizik edhe i automjetit me targa italiane CJ 9668BM, që drejtohej nga i gjykuari Lodoviko Salis (shtetas italian). Në përfundim të kontrollit është konstatuar se në serbatorin e makinës ishte e paketuar një sasi lëndë pluhur, me peshë 2320 gram. Nga ekspertimi përkatës lënda pluhur u konkludua se ishte heroinë.

Në deklaratimet e tij, i gjykuari Lodoviko Salis ka pranuar se në vitet 2001-2002, në qytetin e Breshias ka njohur një shtetas shqiptar që e thërrisnin "Xhenaro". Pas një viti e gjysmë i gjykuari Lodoviko është kthyer sërish në Breshia dhe ka rënë në kontakt me këtë shtetas shqiptar, i cili i ka propozuar që ta ndihmonte në transportimin nga Shqipëria të lëndës narkotike. I gjykuari Lodoviko ka pranuar dhe i ka kërkuar një mikut të tij italian automjetin.

Më datë 24.12.2004, së bashku me të quajturin "Xhenaro", i gjykuari Lodoviko është nisur në drejtim të Durrësit. Nga materialet portuale ka rezultuar se atë ditë së bashku me Lodovikun ka udhëtuar edhe i gjykuari Enton Leka, i cili në Shqipëri është vënë në kontakt me të vëllanë, të gjykuarin Olsi Leka. Ky i fundit i ka shoqëruar për në hotel "Ballkan", në Tiranë.

I gjykuari Lodoviko ka pretenduar se në asnjë rast "Xhenaro" nuk ka dashur të zbulojë identitetin e tij të vërtetë. Vetëm në një rast ai i kishte parë një kartë identifikimi që i quajturin "Xhenaro" mbante, në të cilën ishte fiksuar emri Enton Leka. Gjithashtu, i gjykuari Enton në një rast e kishte thirrur të vëllanë (Olsin) në emër.

I gjykuari Lodoviko ka përshkruar dinamikën e ngjarjeve, duke pohuar se i gjykuari Olsi i ka treguar se kishte gjetur një sasi prej 2 kg lëndë narkotike të një cilësie të mirë. Ditën e fundit, i gjykuari Enton është larguar nga hoteli me makinë, duke i thënë se po shkonte të merrte dhe vendoste lëndën narkotike. Pasi është kthyer në hotel i gjykuari Enton, i gjykuari Lodoviko është vënë në drejtim të automjetit, duke ndjekur nga pas automjetin që drejtohej nga i gjykuari Olsi, pasagjer në të cilin ishte dhe i gjykuari Enton.

Me të arritur në Durrës, vëllezërit Leka i kanë thënë të gjykuarit Lodoviko që të ndiqte nga pas automjetin e tyre teksa kalonin kontrollin e policisë, pasi dhe ata me automjetin e tyre me targa Tiranë do të kalonin për në Itali. Të gjykuarit Leka e kanë kaluar kontrollin policor, ndërsa i gjykuari Lodoviko është kapur në kushtet e flagrancës.

2. Pasi çështja ka ardhur për gjykim në Gjykatën për Krimet e Rënda Tiranë, më datë 31.5.2005, mbështetur në short, është vendosur përbërja e trupit gjykues, respektivisht: S. Simoni -

kryetar i trupit gjykues, D. Hallunaj - gjyqtar relator i çështjes dhe si anëtarë të trupit gjykues gjyqtarët B. Dhama, G. Brahimllari e A. Mustafaj.

Me këtë përbërje të trupit gjykues, ku bënte pjesë dhe gjyqtari S. Simoni, janë çelur seancat gjyqësore të datave 16.6.2005, 1.7.2005, 11.7.2005, në të cilat konstatohet se nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes.

Me urdhrin e datës 8.9.2005 të kryetarit të gjykatës, “*Meqenëse anëtari i trupit gjykues të kësaj çështje gjyqtari Sandër Simoni për arsye pune nuk mund të marrë pjesë në seancën gjyqësore të sotme*”, është urdhëruar ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues duke u zëvendësuar gjyqtari S. Simoni me gjyqtaren M. Balili. Sipas procesverbalit, ky ndryshim është pasqyruar që në seancën e datës 8.9.2005.

Në seancën e datës 7.11.2005 është hapur shqyrtimi gjyqësor dhe në vijim janë zhvilluar disa seanca gjyqësore.

Seancat e datave 8.6.2006 e 16.6.2006 janë shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues, pasi gjyqtarja M. Balili mungonte për arsye shëndetësore.

Në seancën e datës 27.6.2006, rezulton që në vend të gjyqtarës M. Balili, figuron të jetë në përbërje të trupit gjykues gjyqtarja I. Olldashi, e cila ka marrë pjesë deri në fund të gjykimit. Lidhur me këtë ndryshim të trupit gjykues nuk ka pasur kundërshtime nga palët pjesëmarrëse në gjykim. Po kështu, nga akte që përmban dosja gjyqësore nuk rezulton që të ketë ndonjë akt apo urdhër të kryetarit të gjykatës, me të cilin të jetë bërë ky zëvendësim në përbërjen e trupit gjykues.

3. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, Gjykata për Krime të Rënda Tiranë ka disponuar për deklarimin fajtorë të të gjykuarve, duke caktuar edhe masat e dënimit përkatës, sikurse parashtrohet më sipër në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

Mbi ankimin e të pandehurve Olsi Leka, Lodoviko Salis dhe Enton Leka, në mungesë, përfaqësuar nga avokati F. Shanaj, çështja është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit të Krimeve të Rënda.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë, pasi ka shqyrtuar çështjen, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.47, datë 12.12.2006 të Gjykatës për Krimet e Rënda Tiranë.

4. Kundër vendimit nr.8, datë 15.2.2007 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë kanë ushtruar rekurs të gjykuarit Enton Leka dhe Olsi Leka, duke kërkuar prishjen e vendimeve dhe dërgimin e çështjes për rigjykim.

Ndërmjet të tjerave, ashtu sikurse në ankimin që i kishin paraqitur gjykatës së apelit, të gjykuarit parashtrorin edhe në rekurs pretendimin se gjykimi i zhvilluar në Gjykatën për Krimet e Rënda Tiranë dhe, për rrjedhojë, edhe vendimi i dhënë nga ajo gjykatë, janë realizuar në shkelje të rënda procedurale që sjellin si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimeve të gjykatës, sipas parashikimeve të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale. Në përbërje të trupit gjykues kanë marrë pjesë dy gjyqtarë që nuk plotësojnë kushtet për të qenë të tillë, për shkak se, në kundërshtim me ligjin, janë caktuar anëtarë të trupit gjykues jo me short, por njëri me urdhër të kryetarit të gjykatës, ndërsa tjetri pa ndonjë akt të veçantë që të tregojë motivet dhe mënyrën e zëvendësimit të gjyqtarit.

5. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin e datës 19.11.2008, ka vendosur të kalojë çështjen në Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, për njësimin dhe unifikimin e praktikës gjyqësore. Në mënyrë të përmbledhur, Kolegji Penal ka marrë këtë vendim dhe ka parashtruar për diskutim çështjet për unifikim duke pasur parasysh se zëvendësimi i gjyqtarëve gjatë shqyrtimit të çështjes është një veprim i përhapur, faktin që në gjykatat më të ulëta zbatohen praktika të ndryshme, si dhe nisur nga qëndrimet e kundërta mbi kuptimin e zbatimit të ligjit procedural të mbajtura prej tyre por edhe në vetë Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë.

II. Arsyetimi i Kolegjeve të Bashkuara

6. Në seancën gjyqësore, përpara Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, krahas pretendimeve lidhur me mënyrën e zgjidhjes në themel të çështjes nga gjykatat më të ulëta, sikurse në gjykimin në apel dhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, edhe në parashtrimin e qëndrimit të tij përpara Kolegjeve të Bashkuara, mbrojtësi i të gjykuarve Olsi dhe Enton Leka, në thelb, argumentoi se vendimi i dhënë nga Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë është akt absolutisht i pavlefshëm, në kuptim e zbatim të shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale.

Mbrojtja parashtrorin se janë shkelur urdhërimet e ligjit lidhur me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete. Më konkretisht, janë shkelur urdhërimet e nenit 15 të ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor për detyrueshmërinë e caktimit të përbërjes së trupit gjykues nëpërmjet shortit. Kjo dispozitë, sikurse edhe ato të Kodit të Procedurës Penale, nuk i kanë njohur kryetarit të gjykatës ndonjë të drejtë

që, pa treguar arsytet e largimit dhe pa respektuar rregullat e shortit, të urdhërojë e caktojë një gjyqtar në përbërje të trupit gjykues për të zëvendësuar gjyqtarin e caktuar më parë me short.

7. Nga ana tjetër, përfaqësuesi i prokurorisë, në thelb, parashtrori përpara Kolegjeve të Bashkuara se pretendimi i mbrojtjes së të gjykuarve lidhur me rregullshmërinë e caktimit të gjyqtarit në përbërje të trupit gjykues mund të përfshihet si rast në atë që parashikon neni 17, pika 1, shkronja “ë” e Kodit të Procedurës Penale: “ë. Kur ekzistojnë shkaqe të tjera njëanshmërie”.

Gjithsesi, sipas përfaqësuesit të prokurorisë, rastet e parashikuara nga neni 17 i Kodit të Procedurës Penale për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes konkrete, nëse vërtetohen në gjykim, nuk sjellin pavlefshmëri absolute, por pavlefshmëri relative. Vetëm vërtetimi i rasteve të parashikuara nga neni 15 dhe 16 sjell pavlefshmëri absolute të akteve të gjyqtarit në kuptim të nenit 128, pika 1, shkronja “a” të këtij Kodi.

Kushtet për të qenë gjyqtar, në kuptim të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale, lidhen me rastet e shkeljes së ligjit procedural, pikërisht të dispozitave të këtij Kodi dhe jo të atyre që parashikohen në ligje të tjera, përfshirë këtu rregullimet në dispozitat e ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor ku parashikohen rregullat për ndarjen e gjyqtarëve në kolegje e dhoma penale e civile, si dhe rregulli për caktimin me short të gjyqtarit në përbërje të trupit gjykues.

Së fundi, përfaqësuesi i prokurorisë mbajti qëndrimin se respektimi ose jo i rregullave të caktimit me short të trupit gjykues, apo i zëvendësimit të anëtarëve të tij, nuk cenon parimin kushtetues të gjykatës së caktuar me ligj dhe as kushtin për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete, sikurse përcaktohet nga neni 128 i Kodit të Procedurës Penale.

8. Nisur nga parashtrimi i mësipërm i rrethanave të faktit dhe qëndrimeve të palëve në gjykim, për t'i dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara për njësimin e praktikës gjyqësore, gjithmonë në funksion të zgjidhjes së çështjes objekt gjykimi dhe në përgjigje të pretendimeve të parashtruara në rekurs për shkelje të rënda procedurale në gjykim, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se duhet të mbahen parasysh, para së gjithash, dispozitat vijuese të Kushtetutës dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

Në nenet 4, 15 pika 1 dhe 42 pika 2 të Kushtetutës parashikohet se:

“Neni 4

1. E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit.

2. Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë.

3. Dispozitat e Kushtetutës zbatohen drejtpërsëdrejti, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon ndryshe.

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

Neni 42

2. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj”.

Në nenin 6 pika 1 të KEDNJ-së parashikohet se:

“Neni 6 – E drejta për një proces të rregullt

1. Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. ”.

Në pajtueshmëri me qëllimin dhe frymën e këtyre dispozitave, edhe Kodi i Procedurës Penale, në nenin 128, pika 1 shkronja “a” parashikon se:

*“1. Aktet procedurale janë absolutisht të pavlefshme kur nuk respektohen dispozitat që lidhen me:
a- kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete dhe numrin e gjyqtarëve që janë të domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod;.....”.*

Krahas standardeve dhe garancive themeltare në një shtet ligjor për një gjykatë “*të pavarur*” dhe “*të paanshme*”, në shqyrtimin gjyqësor të një çështjeje penale apo civile, parimi dhe standardi tjetër kushtetues, thelbësor për zhvillimin e një procesi të drejtë (të rregullt) ligjor, është ai i gjykatës së “*caktuar me ligj*”.

Parimi dhe garancia kushtetuese e shqyrtimit të çështjes konkrete nga gjykata “*e caktuar me ligj*”, ka të bëjë me respektimin e dispozitave normative që përcaktojnë mënyrën e formimit të gjykatës, kompetencën lëndore, numrin e gjyqtarëve që duhet të përbëjnë trupin gjykues sipas natyrës së çështjes dhe shkallës së gjykimit, si edhe mbi caktimin e përbërjes nominative të trupit gjykues.

9. Për sa i përket mënyrës së formimit të gjykatës dhe përbërjes nominative të saj, nga një vështrim i përmbajtjes dhe zbatimit të kuadrit kushtetues e ligjor në tërësi dhe ligjit procedural penal në veçanti, vërehet se, që nga koha e hyrjes në fuqi dhe deri më sot, në Kodin e Procedurës Penale, ndërsa përmbahen rregullime konkrete lidhur me numrin e gjyqtarëve e kompetencën lëndore në varësi të natyrës së çështjes penale, si dhe mbi kompetencën tokësore, nuk parashikohen rregulla mbi mënyrën e formimit të gjykatës apo për caktimin e përbërjes nominative të saj. Kështu, as neni 333 dhe neni 424 i këtij Kodi nuk tregojnë sesi formohet përbërja nominative e gjykatës së shkallës së parë dhe të apelit. Ndërsa neni 436, lidhur me Gjykatën e Lartë, parashikon vetëm se kryetari i kësaj gjykate cakton kolegjet pesëanëtarëshe për shqyrtimin e rekursve, por nuk shprehet p.sh. se si caktohet gjyqtari relator i çështjes konkrete. Gjithashtu, Kodi nuk përmban rregulla për mënyrën e caktimit të gjyqtarit në përbërje të trupit gjykues në rastet kur lind nevoja e zëvendësimit të njërit prej anëtarëve të trupit gjykues.

Por, në procesin e zhvillimit të legjisllacionit në lidhje me organizimin e gjykatave, duke reflektuar evolucionin e standardeve mbi procesin e rregullt ligjor, nga ana e ligjvënësit është çmuar dhe janë vendosur rregulla më të hollësishme lidhur me mënyrën e formimit të gjykatës penale dhe të përbërjes së saj nominative, nëpërmjet mekanizmit ligjor të shortit, e kombinuar me atë të formimit periodik të kolegjeve dhe dhomave penale në të gjitha shkallët e gjykimit.

Kështu, ligji nr.8436, datë 28.12.1998 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, në nenet 14 dhe 15 të tij (të zbatueshme në çështjen objekt i këtij gjykimi) parashikonte se:

“Neni 14

Në fillim të çdo viti, kryetari i gjykatës së apelit dhe kryetari i gjykatës së shkallës së parë, përcaktojnë për vitin në vazhdim shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma penale e civile të gjykatës.

Në dhomën e çështjeve civile përfshihen edhe gjyqtarët e seksioneve për gjykimet e posaçme.

Kur madhësia e gjykatës nuk lejon të organizohen të paktën një dhomë civile dhe një dhomë penale, ndarja e çështjeve bëhet midis të gjithë gjyqtarëve në mënyrë të barabartë.

Neni 15

Ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhet me short, sipas procedurave të përcaktuara me ligj”.

Edhe ligji në fuqi me nr.9877, datë 18.2.2008 “*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*”, në nenet 9 dhe 18 të tij parashikon se:

“Neni 9 - Ndarja e çështjeve gjyqësore

Ndarja e çështjeve gjyqësore bëhet me short, sipas procedurave të caktuara me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Neni 18 - Kompetencat e kryetarit të gjykatës

1. Një herë në çdo dy vjet kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe kryetari i gjykatës së apelit përcaktojnë shpërndarjen e gjyqtarëve në dhoma dhe seksione për vitet në vijim. Kjo ndarje nuk e pengon

kryetarin e gjykatës që, gjatë vitit kalendarik, për nevoja pune, të komandojë gjyqtarë për të gjykuar në një seksion tjetër.

.....
3. *Kryetari i gjykatës së shkallës së parë dhe Kryetari i gjykatës së apelit, përveç sa më sipër, kryejnë edhe këto detyra:*

.....
b) *bëjnë ndarjen e gjyqtarëve në trupa gjykues;*
c) *në fillim të çdo muaji, bëjnë planifikimin e gjyqtarëve për gjykimet me objekt vlerësim i arrestit në flagrancë apo ndalimit, caktimin e masave të sigurimit dhe çdo kërkesë tjetër gjatë fazës së hetimit, sipas rendit alfabetik, me bazë mbiemrin....”.*

10. Nëse ligji nuk do të parashikonte shortin si mjet për caktimin e gjyqtarit monokratik ose relator të çështjes konkrete, apo vendimin e Kryetarit të gjykatës për caktimin periodik të përbërjes së kolegjit penal, kjo situatë nuk do të mundësonte parashtrimin nga palët në gjykim të pretendimeve dhe përkatësisht disponimit nga gjykata mbi parregullsi në formimin e gjykatës së caktuar me ligj, pra edhe për pavlefshmëri të gjykimit. Maksimumi që mund të pretendohet nga palët, apo që mund të parashtrohet nga gjykata, do të ishte parashtrimi i çështjes së pajtueshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën dhe KEDNJ-në.

Kushtetuta dhe KEDNJ-ja shprehen vetëm për gjykatën e formuar me ligj, pra nuk paracaktjnë shortin, caktimin periodik të kolegjeve penale etj., si mënyra formimi të ligjshëm të gjykatës për shqyrtimin e një çështjeje konkrete, duke ia dhënë ligjvënësit të çmojë dhe përcaktojë mënyrat e formimit dhe caktimit të rregullt të përbërjes nominative të gjykatës për gjykimin e një çështjeje konkrete. Pasi në legjislacionin tonë shorti për çështjen konkrete në kombinim me caktimin periodik të kolegjeve u parashikuan shprehimisht në ligj, pa bërë dallim për çështjet penale apo civile, atëherë këto mënyra të formimit të gjykatës sot përbëjnë një standard, një rregull normativ që, nëse nuk respektohet, sjell vetvetiu parregullshmërinë e përbërjes së gjykatës dhe nulitetin e gjykimit në referim të pikës 2 të nenit 42 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së, në lidhje me shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale.

Nga ana tjetër, duke qenë garanci e parim kushtetues, për të cilën Kushtetuta nuk bën dallim, ajo nuk ndikon mënyrën apo llojin e aktit, por thjesht përcakton se gjykata duhet të caktohet me ligj. Rrjedhimisht Kushtetuta nuk bën asnjë dallim, madje nuk është as edhe vendi për të vënë në diskutim hierarkinë e normave, pra nëse rregullat për formimin e gjykatës duhet të jenë domosdoshmërisht të parashikuara në vetë Kodin e Procedurës Penale apo edhe në ligje të tjera, aq më tepër në rrethanat kur këto rregulla mbi caktimin e përbërjes nominative të gjykatës janë parashikuar në ligje të miratuara nga Kuvendi me 3/5 e anëtarëve të tij. Kjo edhe për arsyen se mënyra e formimit dhe caktimit të përbërjes nominative të gjykatës, nuk janë thjesht çështje organizimi dhe funksionimi të gjykatave, por në thelb lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut, ku bën pjesë edhe rregullshmëria e procesit gjyqësor. Në këtë kuptim, respektimi i procesit të rregullt ligjor përfshin zbatimin e çdo norme ligjore që lidhet me ato elemente e standarde të procesit gjyqësor që garantojnë respektimin e kritereve të pikës 2 të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

Nëse do të gjykohej ndryshe, atëherë në mënyrë të pakuptimtë do të defaktorizohej arsyeja e përcaktimit në ligj të rregullave për formimin e rregullt të gjykatës. Në aspektin e respektimit të parimeve kushtetuese dhe të KEDNJ-së për gjykatën “*e caktuar me ligj*”, do të ishte njësoj sikur të mos respektohej, pra të defaktorizohej edhe rregullimi tjetër ligjor mbi kompetencën lëndore apo edhe mbi numrin e domosdoshëm të gjyqtarëve që formojnë gjykatën sipas natyrës së çështjes, qoftë kur ky rregull të ishte parashikuar apo jo nga vetë Kodi i Procedurës Penale.

Pra, pavarësisht nga diskutimi eventual mbi atë se cila do të ishte mënyra më afër, më e pranueshme dhe më e besueshme për publikun për formimin e përbërjes nominative të gjykatës në çështjen konkrete, me short ose në forma të tjera apo kombinimi i tyre, zgjedhja që bën ligjvënësi duhet të respektohet dhe zbatohet nga gjykatat dhe autoritetet e ngarkuara për këtë qëllim.

11. Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se, *nisur nga dispozitat aktuale në fuqi të sipërcituara në këtë vendim, përbërja nominative e trupit gjykues në një gjykim penal konsiderohet e rregullt vetëm nëse, në varësi të natyrës dhe shkallës së gjykimit, rezulton se janë respektuar e zbatuar procedurat për përcaktimin nominativ të gjykatës monokratike apo të përbërjes së kolegjit që shqyrton një çështje konkrete, ato të përcaktimit periodik të përbërjes nominative të*

dhomave dhe kolegjeve penale për shqyrtimin e çështjeve penale në tërësi, si dhe ato të shortit për caktimin e gjyqtarit relator të çështjes konkrete apo për caktimin e gjyqtarit që zëvendëson anëtarin e trupës gjykuese që ka hequr dorë apo është përjashtuar nga gjykimi i çështjes konkrete.

Duke qenë se cenojnë drejtpërdrejt dhe në thelb parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës (neni 4 i Kushtetutës) dhe të drejtën e njeriut për t'u gjykuar nga një gjykatë "e caktuar me ligj" (nenet 15 dhe 42/2), përbën cenim të procesit të rregullt ligjor thjesht dhe vetëm shkelja e rregullave normative që parashikohen nga ligji për mënyrën e formimit të rregullt të përbërjes nominative të gjykatës në çështjen konkrete. Në kuptim e zbatim të drejtë të nenit 128, pika 1, shkronja "a" të Kodit të Procedurës Penale, aktet e nxjerra nga ajo gjykatë dhe vendimet e dhëna prej saj janë absolutisht të pavlefshme.

12. Në rekursin e paraqitur nga të gjykuarit, sikurse edhe nga parashtrimet e palëve përpara Kolegjeve të Bashkuara, ndonëse qëndrimet e tyre janë të kundërta lidhur me rregullshmërinë ose jo, si dhe efektet përkatëse për sa i përket zëvendësimit të gjyqtarit pa short dhe në tërësi për mënyrën e formimit të përbërjes nominative të gjykatës, vërehet se, gjithsesi, ato e lidhin vetvetiu respektimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj me institutin procedural të paanshmërisë së gjykatës në gjykimin e një çështjeje konkrete. Për rrjedhojë, edhe me shkaqet (rastet), sjelljen e kërkimit e palës dhe disponimet e gjykatës për heqjen dorë të gjyqtarit apo përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjes, sikurse parashikohen nga nenet 15 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se dispozita e pikës 2 të nenit 42 të Kushtetutës parashikon shprehimisht tre parime, tre garanci kushtetuese, për respektimin e procesit të rregullt ligjor në një shtet të së drejtës, ato të "pavarësisë" së gjykatës, të "paanshmërisë" së saj dhe parimin e "gjykatës së caktuar me ligj".

Këto tri garanci kushtetuese lidhen me aspekte të ndryshme të procesit të rregullt ligjor. Vërtetimi në gjykim i cenimit të njërit prej tyre nuk nënkupton dhe as nuk sjell domosdoshmëri dhe vetvetiu si efekt cenimin e njërit apo të dy garancive të tjera kushtetuese.

Rrethana e njëanshmërisë së gjyqtarit në gjykimin e një çështjeje konkrete mund të lindë krahas apo pavarësisht nga mënyra e formimit, numri i gjyqtarëve dhe mënyra e caktimit të përbërjes nominative të gjykatës.

13. Prandaj Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin unifikues se, *mosrespektimi i rregullave normative mbi mënyrën e formimit, numrin e gjyqtarëve apo për caktimin e përbërjes nominative të trupit gjykues nuk ka lidhje dhe as nënkupton, vetvetiu, "njëanshmërinë" e gjykatës, për rrjedhojë vënien në zbatim nga palët dhe gjykatat të mjeteve procedurale të kërkesës për përjashtim apo heqjes dorë nga gjykimi i çështjes. Kjo gjendje nuk lidhet me perceptimin subjektiv apo objektiv mbi cilësitë, rrethanat, qëndrimin dhe sjelljen e gjyqtarit brenda apo jashtë, përpara apo gjatë gjykimit të një çështjeje konkrete.*

Gjyqtari mund të jetë caktuar në përbërje të trupit gjykues pa u respektuar, sipas rastit, rregullat mbi mënyrën e formimit të kolegjeve gjykuese apo ato të shortit, po kështu gjykata mund të jetë formuar me një numër më të vogël se ajo që parashikon ligji, por këto rrethana nuk e bëjnë gjyqtarin apo gjithë gjyqtarët e trupit gjykues të njëanshëm. Prandaj, nëse për riparimin e këtyre parregullsive zhvillohen e respektohen rregullat për formimin e gjykatës sipas ligjit, në përbërje të trupit gjykues mund të jenë po ata gjyqtarë.

Nëse përveç parregullsive në caktimin e përbërjes nominale të gjykatës, pretendohet e motivohet se gjithë kjo ka ndodhur qëllimisht për motive njëanshmërie apo një a disa anëtarë të trupës gjykuese kanë shkaqe të tjera përjashtimi sipas nenit 15 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, atëherë, krahas kërkesës për formimin e parregullt të gjykatës, kërkohet edhe përjashtimi eventual, në çdo rast, të gjyqtarit që është caktuar në përbërje të trupit gjykues të formuar në mënyrë të parregullt.

14. Nisur nga rëndësia thelbësore që kanë për zhvillimin e një gjykimi të drejtë si rezultat i një procesi të rregullt ligjor, mënyra dhe mjeti eventual ligjor i zbatuar për formimin e gjykatës apo për zëvendësimin e një anëtari ekzistues të trupës gjykuese, duhet t'i bëhen të njohura palëve nga kryetari i trupit gjykues në momentin e shpalljes së përbërjes së gjykatës të caktuar për shqyrtimin e asaj çështjeje, apo në fillim të çdo seance pasardhëse, sa herë që ka ndryshime në përbërjen e gjykatës. Realizimi i këtij njoftimi pasqyrohet në procesverbalin e seancës gjyqësore.

Në këtë mënyrë jo vetëm i mundësohet, por edhe i garantohet palës pjesëmarrëse në gjykim e drejta që, në çdo kohë, të paraqesë para gjykatës pretendimin e saj për formimin e parregullt të gjykatës.

Gjykata duhet t'i japë përgjigje këtij pretendimi me vendim të ndërmjetëm dhe nëse e pranon, shtyn seancën për të mundësuar që të riparohet shkelja dhe gjykata të formohet rregullisht. Gjithashtu, gjykata mund të marrë kryesisht në bisedim ekzistencën ose jo të rrethanës së formimit të parregullt të gjykatës.

15. Prandaj, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, mbështetur në analizën mbi zbatimin e ligjit e përfundimet unifikuese të lartpërmendura, pretendimet e parashtruara në rekursin e paraqitur nga të gjykuarit Enton Leka, mbrojtësi i tij dhe Olsi Leka janë të mbështetura në ligj.

Sikurse ka rezultuar e vërtetuar nga vendimet e dhëna nga dyja gjykatat më të ulëta dhe aktet që përmban dosja gjyqësore, pasi çështja ka ardhur për gjykim në Gjykatën për Krimet e Rënda Tiranë, më datë 31.5.2005, mbështetur në short, është vendosur përbërja e trupit gjykues, respektivisht: S. Simoni - kryetar i trupit gjykues, D. Hallunaj - gjyqtar relator i çështjes dhe si anëtarë të trupit gjykues gjyqtarët B. Dhama, G. Brahimllari e A. Mustafaj.

Me këtë përbërje të trupit gjykues, ku bënte pjesë dhe gjyqtari S. Simoni, janë çelur seancat gjyqësore të datave 16.6.2005, 1.7.2005, 11.7.2005, në të cilat konstatohet se nuk ka filluar shqyrtimi gjyqësor i çështjes.

Por, me urdhrin e datës 8.9.2005 të kryetarit të gjykatës, "*Meqenëse anëtari i trupit gjykues të kësaj çështjeje gjyqtari Sandër Simoni për arsye pune nuk mund të marrë pjesë në seancën gjyqësore të sotme*", është urdhëruar ndryshimi i përbërjes së trupit gjykues duke u zëvendësuar gjyqtari S. Simoni me gjyqtaren M. Balili. Sipas procesverbalit, ky ndryshim është pasqyruar që në seancën e datës 8.9.2005.

Në seancën e datës 7.11.2005 është hapur shqyrtimi gjyqësor dhe në vijim janë zhvilluar disa seanca gjyqësore.

Seancat e datave 8.6.2006 e 16.6.2006 janë shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues, pasi gjyqtarja M. Balili mungonte për arsye shëndetësore.

Në seancën e datës 27.6.2006 rezulton që në vend të gjyqtares M. Balili, figuron të jetë në përbërje të trupit gjykues gjyqtarja I. Olldashi, e cila ka marrë pjesë deri në fund të gjykimit. Lidhur me këtë ndryshim të trupit gjykues nuk ka pasur kundërshtime nga palët pjesëmarrëse në gjykim. Po kështu, nga aktet që përmban dosja gjyqësore nuk rezulton që të ketë ndonjë akt apo urdhër të kryetarit të gjykatës, me të cilin të jetë bërë ky zëvendësim në përbërjen e trupit gjykues.

16. Në rrethana të tilla, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se Gjykata e Apelit për Krime të Rënda ka zbatuar gabim ligjin procedural, posaçërisht dispozitën e shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale, kur nuk ka pranuar pretendimin e ngritur nga të gjykuarit në ankim për konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr.47, datë 12.12.2006 të Gjykatës për Krime të Rënda, pasi në marrjen e tij nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete dhe numrin e gjyqtarëve të domosdoshëm për formimin e kolegjeve.

Urdhri i kryetarit të gjykatës është një veprim ekstraprocedural. Të tilla janë edhe zëvendësimet që i janë bërë gjyqtarëve mbi bazën e urdhrave të kësaj natyre, çka e bën të gjithë procesin proceduralisht të cenueshëm. Në nenin 15 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 "*Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë*", të zbatueshëm në çështjen objekt i këtij gjykimi, ku parashikohet se: "*Ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhet me short sipas procedurave të përcaktuara me ligj.*", ashtu edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, është rregulluar mënyra dhe rastet e largimit të një gjyqtari nga trupi gjykues, mënyrë që nuk lejon kryetarin e gjykatës të ndërhyjë. Gjyqtari i caktuar sipas shortit në trupin gjykues zëvendësohet po me short në rastet kur heq dorë, pranohet kërkesa për përjashtimin e tij, apo për shkaqe të tjera të përligjura.

Kryetari i gjykatës është figurë procedurale për aq të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga Kodi i Procedurës Penale dhe ligji, tek të cilat, nuk ka asnjë dispozitë që t'i njohë atij të drejtën për të ndryshuar trupin gjykues.

Prandaj, si përfundim, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se, në çështjen objekt gjykimi, përderisa ndryshimi i trupit gjykues është bërë në një rast me urdhër të kryetarit të gjykatës dhe, në rastin tjetër pa short e pa treguar arsyen dhe mënyrën e zëvendësimit të gjyqtarit ekzistues, pra jashtë rregullimeve procedurale e ligjore, ky trup gjykues vlerësohet se nuk është formuar rregullisht, duke qenë kështu një nga rastet që, në kuptim të shkronjës "a" të pikës 1 të nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale, e bëjnë vendimin nr.47, datë 12.12.2006 të Gjykatës për Krime të Rënda një akt absolutisht të pavlefshëm.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në mbështetje të pikës 2 të nenit 141 të Kushtetutës, të shkronjës “b” të pikës 1 të nenit 432, të nenit 438, të shkronjës “ç” të pikës 1 të nenit 441 dhe nenit 443 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe të shkronjës “a” të nenit 17 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSËN:

1. Prishjen e vendimit nr.8, datë 15.2.2007 të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.47, datë 12.12.2006 të Gjykatës për Krimet e Rënda Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën për Krimet e Rënda Tiranë, me tjetër trup gjykues.
2. Unifikimin e praktikës gjyqësore sikurse përcaktohet në këtë vendim.
3. Dërgimin për botim në Fletoren Zyrtare të këtij vendimi që njëson praktikën gjyqësore.

Anëtarë pro: Shpresa Beçaj (kryesuese) Ardian Dvorani, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Mirela Fana, Guxim Zenelaj, Andi Çeliku

Anëtarë kundër: Ardian Nuni, Arjana Fullani, Majlinda Andrea, Evelina Qirjako, Aleksandër Muskaj.

MENDIMI I PAKICËS

1. Ne, gjyqtarët në pakicë, Ardian Nuni, Arjana Fullani, Aleksandër Muskaj, Majlinda Andrea dhe Evelina Qirjako, jemi të mendimit se për rastin në shqyrtim nuk ndodhemi përpara një procesi jo të rregullt ligjor dhe as përpara pavlefshmërisë absolute të akteve procedurale, sikurse pranon shumica e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

2. Pakica vlerëson se qëndrimi njësuës i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me parimin kushtetues të *“një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*, ka dalë tej kornizës juridike të dispozitave kushtetuese, të Kodit të Procedurës Penale dhe të rrethanave të çështjes konkrete.

3. Sikurse Kolegjet e Bashkuara, edhe pakica mendon se është vendi të trajtohet me këtë rast kuptimi i drejtë dhe realist që duhet pasur për standardin e gjykatës së pavarur, të paanshme dhe të caktuar me ligj. Edhe për pakicën, pavarësia dhe paanshmëria e secilit prej anëtarëve të trupit gjykues dhe e gjykatës në tërësi, konsiderohen parime të rëndësishme, që garantojnë dhënien e vendimeve të drejta dhe që mundësojnë krijimin e besimit tek gjykata.

4. Në thelb, problemi i shtruar para Kolegjeve të Bashkuara ka të bëjë me formimin e gjykatës dhe përbërjes nominative të saj, që referon në parimin e gjykatës së caktuar me ligj. Në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e pushtetit gjyqësor dhe në Kodin e Procedurës Penale janë përcaktuar rregullimet konkrete në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore, me numrin e gjyqtarëve, si dhe rastet e papajtueshmërisë në funksionin e gjyqtarit. Ndërsa në lidhje me formimin e gjykatës dhe përbërjen nominative të saj nuk ka dispozita specifike të cilat të rregullojnë në mënyrë të detajuar këtë çështje.

5. Në referencë të legjislacionit të zbatueshëm, edhe tej momentit të dhënies së vendimeve për çështjen konkrete nga Gjykata për Krimet e Rënda Tiranë (vendimi nr.47, datë 12.12.2006) dhe Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda Tiranë (vendimi nr.8, datë 15.2.2007), konstatohet paqëndrueshmëri në lidhje me procedurën që duhet ndjekur për mënyrën e formimit të përbërjes nominative të trupit gjykues. Kështu, në nenin 15 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” përcaktohej se *“Ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhet me short sipas procedurave të përcaktuara me ligj”*, ndërsa me ligjin nr.9877, datë 18.2.2008, që ka shfuqizuar ligjin e mësipërm, përcaktohet se *“Ndarja e çështjeve gjyqësore bëhet me short, sipas procedurave të caktuara me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”* (neni 9).

6. Evidentohet se deri në momentin e shpalljes së vendimit nga Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda, as për rastin e parë dhe as për të dytin nuk ka pasur rregullime përkatëse në zbatim të këtyre dispozitave.

6.1. Aktet, mbi bazën e të cilëve është mundësuar ndarja e çështjeve gjyqësore, kanë qenë: i) urdhri nr.1830, datë 3.4.2001 i Ministrisë të Drejtësisë “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e administratës gjyqësore””, sipas të cilit organizimi dhe dokumentimi i shortit realizohej nga kancelari nën mbikëqyrjen e kryetarit të gjykatës (nenet 8 dhe 11) dhe ii) vendimi nr.238/1/a, datë 24.12.2008 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, me të cilin, *inter alia*, janë miratuar dhe procedurat e ndarjes me short të çështjeve gjyqësore.¹

6.2. Në vështrim të këtyre rregullimeve, ndarja e çështjeve gjyqësore me anë të shortit rezultoi të jetë një veprim jashtë rregullave procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale dhe mosrespektimi i tyre nuk përbën shkak për pavlefshmëri absolute në kuptim të nenit 128/1, germa “a” të po këtij Kodi. Këto akte nuk mund të njësohen me rregullimet e rasteve të përjashtueshmërisë të gjyqtarit të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale.

7. Pakica mendon se në kushtet ekzistuese të legjislacionit procedural penal dhe kur në asnjë ligj tjetër të veçantë nuk është parashikuar mënyra e formimit të përbërjes nominale të trupit gjykues, rregulli i ndjekur për caktimin e gjyqtarit zëvendësues, përderisa nuk bie ndesh me dispozitat kushtetuese dhe me ato të Kodit të Procedurës Penale, nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor.

8. Për më tepër, kur përbërja nominative e trupit gjykues apo zëvendësimi i gjyqtarit nuk është kundërshtuar nga subjektet pjesëmarrëse në procesin gjyqësor, qoftë dhe për ndonjë arsye subjektive (sipas neneve 18-20 të Kodit të Procedurës Penale) nuk rrjedhon *a priori* në pavlefshmëri absolute, në kuptim të nenit 128, pika 1, germa “a” të Kodit të Procedurës Penale.

9. Në lidhje me çështjet e shtruara për njësim të praktikës gjyqësore, ndryshe nga Kolegjet e Bashkuara, në opinionin e saj ligjor, pakica vlerëson përkatësisht:

I. A mund të zgjerohen rastet e papajtueshmërisë në funksionin e gjyqtarit në gjykim, veç atyre që parashikohen në nenet 15, 16 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale?

10. Rastet e papajtueshmërisë në funksionin e gjyqtarit në gjykim nëpërmjet interpretimit gjyqësor nuk mund të zgjerohen tej atyre të parashikuara në nenet 15, 16, 17 dhe 342/4 të Kodit të Procedurës Penale.

10.1. Çdo zgjerim i rasteve të papajtueshmërisë në funksionin e gjyqtarit, veç atyre të parashikuara në këto dispozita, bie ndesh jo vetëm me parimet kushtetuese, por dhe me atë ç’ka ka në funksion gjykata, qofshin dhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Gjykata nuk mund të shtojë raste të tjera veç atyre që janë parashikuar shprehimisht në ligj, por ajo, në interpretim të drejtë, duke nxjerrë kuptimin e saktë të dispozitës ligjore, e zbaton atë për çështjen konkrete.

II. “Mungesa e paanshmërisë së gjyqtarit në gjykimin e një çështjeje konkrete duhet t’i nënshtrohet procesit të të provuarit, apo vetëm të pretendohet? Pra në rastin e zëvendësimit të gjyqtarit/ve të trupit gjykues, që është duke gjykuar një çështje konkrete, mungesa e paanshmërisë është e prezumuar, apo duhet t’i nënshtrohet provës?

11. Në lidhje me pyetjen e dytë, në kuptim të dispozitave kushtetuese, të legjislacionit organik, si dhe atyre të Kodit të Procedurës Penale, paanshmëria e gjyqtarit për të gjykuar një çështje konkrete prezumohet.

11.1. Si rregull, supozohet që gjyqtari është subjekt personalisht i paanshëm, me përjashtim të rasteve kur dalin prova të kundërta.²

11.2. Kush pretendon se gjyqtari ka shkaqe për njëanshmëri duhet të provojë ekzistencën e këtyre shkaqeve dhe të kërkojë përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjes konkrete.

11.3. Pretendimi për mungesë të paanshmërisë së gjyqtarit, i cili plotëson kushtet për të qenë gjyqtar, në gjykimin e një çështjeje konkrete, duhet t’i nënshtrohet provave.

¹ Neni 6 i vendimit nr.238/1/a, datë 24.12.2008 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë: “Në rastin kur një prej anëtarëve të trupit gjykues vlerësohet se ka një shkak për përjashtim ose është në pamundësi të përkohshme paraqitjeje, plotësimi i trupit gjykues bëhet me caktimin në vend të tij të një gjyqtari tjetër, me përzgjedhje nga kryetari i gjykatës. Në përzgjedhjen e gjyqtarit më të përshatshëm, kryetari i gjykatës mban parasysht një trajtim të njëjtë mes gjyqtarëve, duke konsideruar ngarkesën e secilit dhe seksionin përkatës”.

² Gjykata e Strasburgut në çështjen “Le Conepte, Van Leuven dhe De Meyere kundër Belgjikës”.

11.4. Në çështjen objekt gjykimi, nuk është shprehur asnjë dyshim apo rezervë nga palët për gjyqtarin zëvendësues. Përkundrazi, sikundër rezulton nga aktet procedurale, ato janë shprehur dakord për zëvendësimin. Por, edhe sikur të ishin shprehur dyshime apo rezerva për paanshmërinë e tyre nga të pandehurit apo mbrojtësit e tyre, përsëri pakica mendon se ato nuk do të ishin të mjaftueshme për të arritur në përfundimin për anësi në gjykim të tyre, derisa të provohej se ato ishin "objektivisht të justifikueshme".¹

III. "Shorti në nenin 9 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", parashikohet si mënyrë e ndarjes së çështjeve gjyqësore, a duhet të shtrihet, si formë organizimi edhe në caktimin e gjyqtarëve të trupit gjykues që do të gjykojnë secilin prej tyre ?

12. Shorti (caktimi i anëtarëve të trupit gjykues) nuk është veprim procedural i parashikuar në Kodin e Procedurës Penale. Shorti është parashikuar në ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor si mënyrë e organizimit të punës nga drejtuesit e gjykatave.

12.1. Si formë organizimi, do të ishte më e gjetur që shorti të shtrihet edhe në caktimin e anëtarëve të trupit gjykues. Por nga sa ka qenë parashikuar në nenin 15 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 dhe parashikohet në nenin 9 të ligjit nr.9877, datë 18.2.2008, si dhe në vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, një gjë e tillë nuk përbën detyrim ligjor për organizuesit e shortit. Megjithatë, pavarësisht mungesës së normave juridike konkrete, i vlerësueshëm është aplikimi nga gjykatat i kësaj forme për caktimin e përbërjes së trupit gjykues.

IV. "Shorti, si masë organizative (e cila parashikohet në një ligj organik), a duhet të konsiderohet rregull i barasvlefshëm me rregullat procedurale që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale, mosrespektimi i të cilave passjell pasoja në kuptimin e procesit të rregullt ligjor?

13. Mosrespektimi i normave procedurale penale passjell, sipas rastit, pavlefshmërinë absolute ose relative të akteve procedurale. Për sa i përket mosrespektimit të rregullave jashtë procedurës penale (sikundër janë rregullimet aktuale lidhur me shortin), përfshirë dhe ndryshimin apo zëvendësimin e anëtarëve të trupit gjykues, ato janë të asaj kategorie të cilat gjykata më e lartë ia vë në dukje gjykatës që ka gjykuar çështjen si të metë për të mos e përsëritur në të ardhmen, por që nuk përbëjnë shkak për pavlefshmëri absolute të gjyqimit.

13.1. Pakica mendon se shorti si masë organizative nuk duhet të konsiderohet rregull i barasvlefshëm me rregullat procedurale që parashikohen në Kodin e Procedurës Penale.

13.2. Ndër të tjera, nëpërmjet shortit nuk mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv, por rregullohet dhe parandalohet abuzimi i mundshëm në lidhje me përbërjen e trupit gjykues, nëpërmjet përdorimit të metodave selektive.

14. Shprehja "gjykatë e krijuar me ligj" përfshin jo vetëm bazën ligjore për ekzistencën e një gjykatë, por gjithashtu dhe përbërjen e trupës gjykuese në çdo çështje.²

14.1. Në këtë kuptim dhe në vijim të argumenteve të mësipërme, pakica mendon se me përbërjen e trupit gjykues lidhen pazgjidhshmërisht parimet e pavarësisë dhe të paanshmërisë. Ky i dyti ka në vetvete elementin e vet subjektiv, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin objektiv, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimit prej saj të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim.³

15. Sikundër vlerësuam, në përgjigje të pyetjes së dytë, e gjejmë me vend të parashtrijmë se ekzistenca e paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar dy teste: **testin objektiv, që shqyrton nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë, dhe testin subjektiv, që ka të bëjë me bindjen e brendshme të gjyqtarit për mënyrën e zgjidhjes së çështjes. Nga pikëpamja e testit subjektiv, gjykimi konsiderohet i paanshëm derisa njëra nga palët, në rrjedhën e procesit, të paraqesë prova për të vërtetuar të kundërtën**⁴.

15.1. Nga këndvështrimi i testit subjektiv, rekursuesi nuk ka vënë në dyshim bindjen e brendshme të gjyqtarit përkatës për mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

¹ Gjykata e Strasburgut në çështjen "Haschildt kundër Danimarkës".

² Gjykata e Strasburgut në çështjen "Buscarimi v San Marino" (dec), nr.31657/96, 4 maj 2000.

³ Vendim nr.12, datë 13.4.2007 i Gjykatës Kushtetuese.

⁴ vendimet nr.7, datë 11.3.2008 dhe nr.11, datë 2.4.2008 të Gjykatës Kushtetuese.

16. Për më tej, në shqyrtim të pretendimeve të rekursuesit nga pikëpamja e testit objektiv parashtrijmë:

16.1. Në rrethanat specifike të çështjes në shqyrtim, edhe konstatimi i ekzistencës së një defekti apo të mete në procesin e organizimit të shortit nuk përbën i vetëm shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Së pari, edhe pse gjyqtari u ndryshua për shkaqe të arsyeshme, gjyqtari zëvendësues dhe anëtarët e tjerë të trupit gjykues mbetën të njëjtë gjatë gjithë procesit. Së dyti, besueshmëria dhe paanësia e këtij gjyqtari nuk u vu dhe nuk është vënë në diskutim nga të pandehurit për asnjë moment, madje edhe gjatë gjykimit para Kolegjeve të Bashkuara, nuk u ngrit ndonjë pretendim i tillë që të vinte në dyshim paanshmërinë e tij. Së treti, nuk ka asnjë pretendim se gjyqtari zëvendësues ka ndikuar në zgjidhjen e çështjes ose për ndonjë motiv tjetër të papërshtatshëm. Në këto kushte, fakti se zëvendësimi i gjyqtarit është bërë pa short nuk mund të përbëjë shkak për të konsideruar procesin si të parregullt.

16.2. Gjithashtu konstatohet se nga rekursuesi apo nga ndonjë palë tjetër e gjykimit nuk janë kundërshtuar ndryshimet e anëtarëve të trupit gjykues.

16.3. Në këto rrethana, pakica vlerëson se Gjykata e Krimeve të Rënda Tiranë, në përbërje të së cilës ka qenë edhe gjyqtari I. Olldashi, **i ka ofruar palëve garancitë e nevojshme të cilat iu kanë larguar atyre dyshimin për njëanshmërinë e gjykatës.**

17. Lidhur me pretendimin se gjykimi në Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë nuk është bërë nga gjykatë e caktuar me ligj për aq sa nuk janë respektuar kërkesat për hedhjen e shortit dhe të formimit të trupit gjykues, pakica gjykon se mosrealizimi i shortit në zëvendësimin e gjyqtarit për shkaqe të parashikuara në nenin 342/4 të Kodit të Procedurës Penale nuk ka sjellë asnjë cenim të të drejtave apo interesave të ligjshme të të pandehurit.

17.1. Përkundrazi, konstatohet se të pandehurit gjatë gjykimit në Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë nuk i është cenuar asnjë e drejtë procedurale. Kjo palë ka marrë pjesë në gjykim, është dëgjuar e mbrojtur, ka paraqitur provat e vlerësuara prej saj si të nevojshme për këtë gjykim dhe ka diskutuar mbi to, ka debatuar në lidhje me pretendimet e palës akuzuese.

18. Nga ana tjetër, nuk evidentohet asnjë nga rastet e papajtueshmërisë me funksionin e ndonjë prej gjyqtarëve në gjykimin e çështjes, prania e të cilëve do të bënte që të mungonin kushtet për qenien e tij anëtar i trupit gjykues dhe për rrjedhojë do të bënin edhe vendimin absolutisht të pavlefshëm (shkronja “a” e nenit 128/1 të Kodit të Procedurës Penale).

18.1. Rastet e parashikuara nga neni 17 i Kodit të Procedurës Penale për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi i çështjes konkrete, nëse vërtetohen në gjykim, nuk sjellin pavlefshmëri absolute, por pavlefshmëri relative. Vetëm vërtetimi i rasteve të parashikuara nga nenet 15 dhe 16 sjell pavlefshmëri absolute të akteve të gjyqtarit në kuptim të nenit 128, pika 1, germa “a” të këtij Kodi.

19. Veç kësaj, sikurse u argumentua më sipër, referimi i rekursuesit në nenin 15 të ligjit nr.8436, datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” nuk ka lidhje me rastin e pavlefshmërisë absolute të parashikuar nga germa “a” e nenit 128 të Kodit të Procedurës Penale. Kjo edhe për faktin se në këtë dispozitë veç sa thuhet se “*Ndarja e çështjeve gjyqësore në të gjitha hallkat e sistemit gjyqësor bëhet me short sipas procedurave të përcaktuara me ligj*”. Pra nuk janë përcaktuar procedurat që duhet të ndiqen për ndarjen e çështjeve gjyqësore dhe as karakteri i kësaj procedure në raport me dispozitat e ligjit procedural penal, për rastet kur kjo procedurë nuk respektohet.

20. Ndryshe nga sa është pranuar nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nuk evidentohet asnjë “element procedural” që të ketë pasur ndikim në dëm të zgjidhjes së drejtë të çështjes, përmbajtjes së vendimit dhe në dëm të interesave të palëve. Nëse ndikimi do të kishte qenë thelbësor dhe njëkohësisht të vërtetohej, atëherë do të ishim para shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

21. **Për rastin në shqyrtim, vlerësojmë se zëvendësimi i gjyqtarëve i pakontestuar nga palët nuk përbën cenim të procesit të rregullt ligjor dhe nuk mund të sjellë pavlefshmëri absolute. Për rrjedhojë nuk ndodhemi përpara mosrespektimit të parimeve kushtetuese të zhvillimit të një procesi gjyqësor nga një gjykatë e paanshme dhe e caktuar me ligj, të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.**

22. Në argumentim sa sipër, mendojmë se nuk ka shkaqe ligjore që Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të prishnin vendimet e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë dhe dërgonin çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Krimeve të Rënda Tiranë.

Anëtarë: Arjana Fullani, Evelina Qirjako, Ardian Nuni, Aleksandër Muskaj, Majlinda Andrea.

VENDIM
Nr.8, datë 10.6.2011

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, të përbëra nga:

Shpresa Beçaj	Kryesuese
Besnik Imeraj	Anëtar
Gani Dizdari	Anëtar
Ardian Dvorani	Anëtar
Fatos Lulo	Anëtar
Ardian Nuni	Anëtar
Guxim Zenelaj	Anëtar
Arjana Fullani	Anëtare
Aleksandër Muskaj	Anëtar
Evelina Qirjako	Anëtare
Majlinda Andrea	Anëtare
Andi Çeliku	Anëtar
Mirela Fana	Anëtare
Medi Bici	Anëtar

në seancat gjyqësore të datave 31.5.2011, 1.6.2011 dhe 10.6.2011 morën në shqyrtim çështjen civile nr.7 Akti, që u përket:

PADITËSE: Eriona Haxhiaj, përfaqësuar nga avokate Erinda Ballanca.

I PADITUR: Chemonics International Inc, zyrë përfaqësimi, Tiranë, përfaqësuar nga avokati Fatos Lazimi.

OBJEKTI I PADISË: Konstatimi i zgjidhjes së marrëdhënies së punës me shkak abuziv, detyrimi i punëdhënësit të dëmshpërblejë paditësen me pagën e një viti pune për shkak të zgjidhjes së kontratës për shkak abuziv; konstatim i zgjidhjes për shkak të paarsyeshëm dhe detyrimi për të dëmshpërblyer me pagën e një viti pune; pagimi i dy muajve pagë për mosrespektim të procedurës dhe pagimi i pushimeve të papaguara.

BAZA LIGJORE: Neni 31 e vijues të Kodi të Procedurës Civile nenet 7, 12, 21, 24, 32, 140, 144, 146, 153, 155 të Kodit të Punës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.4088 Akti, datë 12.4.2010, ka vendosur:

Rrëzimin e kërkesës për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit.

Kundër vendimit ka ushtruar ankim të veçantë ana e paditur, Chemonics International INC, regjistruar si zyrë përfaqësimi me të cilin kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare, për këto shkaqe:

- Vendimi i gjykatës është produkt i mungesës së një analize dhe interpretimi të plotë të dispozitave të marrëveshjes ndërkombëtare - Marrëveshja bilaterale ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës e datës 10.6.1992.

- Kjo marrëveshje është ende në fuqi dhe për rrjedhojë qëndron në superioritet/prevalon ndaj legjisllacionit të brendshëm. Fakt ky që nuk është adresuar në mënyrën e duhur nga gjykata.

- Meqenëse çështja e shtruar për zgjidhje para gjykatës përmban elemente të huaja, çështja e juridiksionit do të gjejë zgjidhje nëpërmjet parimeve, standardeve dhe normave ligjore të së drejtës ndërkombëtare private. Vendimi i gjykatës referon përciptazi në këto akte dhe nuk thellohet në elementet kyçe që përcaktojnë juridiksionin e çështjes konkrete.

- Gjykata gabimisht arrin në konkluzionin se nuk plotësohen në mënyrë kumulative të dyja kushtet e kërkuara nga marrëveshja bilaterale. Kështu, vlerësohet se marrëveshja nuk ofron imunitet në lidhje me kontratat e punës lidhur midis anës së paditur si punëdhënëse dhe paditëses si punëmarrëse, pasi kjo kontratë nuk është si kontratat e tjera dhe, po sipas gjykatës, ligji i aplikueshëm selektohet në bazë të parimit *lex loci laboris* (ligji më i favorshëm për punëmarrësin).

- Përkundrazi, kontrata e punës, në kuadrin e Projektit të Administratës Publike, për të cilin është kontraktuar i padituri nga USAID, është në vlerë si të gjitha kontratat e tjera të shërbimit, përmes të cilave përmbushen në mënyrë direkte objektivat e veprimtarisë së të paditurit.

- Pritshmëria nga kontrata e punës me paditësen ishte e lartë dhe e lidhur drejtpërdrejt me realizimin e një prej objektivave madhorë të projektit në tërësi, atë të procedurave të licencimit të biznesit në Shqipëri. Për rrjedhojë, shërbimet që priteshin të jepeshin nga paditësja, si pasojë e kontratës së punës nuk mund të mos konsiderohen si veprime që lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e aktiviteteve të të paditurit. Nuk ka argument që të mbështesë që veprimtaria e paditësit është jashtë përgjegjësisë civile që lidhen drejtpërdrejt me objektivat e projektit.

- Përgjegjësitë civile të një kontrate pune përfshihen brenda frymës dhe objektit të përcaktuar në nenin 3/d të marrëveshjes.

- Në nuk kontestojmë ligjin e zbatueshëm, që është ai shqiptar, por kjo nuk do të thotë se vetëm gjykatat shqiptare mund të zbatojnë ligjin e huaj. Si një çështje e së drejtës ndërkombëtare private edhe një forum i huaj, i cili duhet të vendosë juridiksionin mbi një çështje në bazë të një kushti ligjor, mund të zgjidhë mosmarrëveshjen duke zbatuar ligjin shqiptar në mënyrë të detyrueshme.

- Çdo zgjedhje e vullnetshme e palëve përmes kontratës në lidhje me juridiksionin e forumit rezulton si kusht nul i pavlefshëm në raport me një normë të karakterit urdhërues e prevalues, siç është neni 3/d i marrëveshjes.

- Gjykata duhet të kishte pasur parasysh nenin 31 të ligjit nr.3920, datë 21.11.1964 “Për të drejtat e të huajve dhe zbatimin e ligjit të huaj”.

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relatimin e çështjes nga gjyqtarët Ardian Nuni dhe Arjana Fullani; përfaqësuesin e palës së paditur, avokatin Fatos Lazimi, që kërkoi prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare; përfaqësuesin e palës paditëse, avokaten Erinda Ballanca, që kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; dhe pasi shqyrtuan dhe analizuan në tërësi çështjen,

VËREJNË:

Rrethanat e çështjes

1. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se paditësja Eriona Haxhiaj ka qenë në marrëdhënie pune pranë anës së paditur në pozicionin e Këshilltarit të Licencimit të Biznesit, me kontratë me afat të përcaktuar nga data 16.2.2009 deri më datë 22.1.2010.

2. Ana e paditur e këtij gjykimi, Chemonics International INC është zyrë e përfaqësimit të Kompanisë Chemonics International INC, shoqëri e themeluar sipas ligjit të përgjithshëm të shoqërive të shtetit Delaware. Zyra e përfaqësimit në Shqipëri është regjistruar me vendimin nr.36 546, datë 13.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në ushtrim të aktivitetit për zbatimin e projektit të reformës së Administratës Publike në Shqipëri ka kontraktuar me USAID, organizatë publike e krijuar nga qeveria e SHBA-së dhe financohet prej saj.

3. Me shkresën e datës 17.6.2009, ana e paditur ka njoftuar paditësen për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës dhe i ka kërkuar të paraqitet në datë 24.6.2009 për bisedime rreth arsyeve të zgjidhjes së kësaj kontrate. Më datë 24.6.2009 paditëses i është njoftuar vendimi përfundimtar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.

4. Paditësja, Eriona Haxhiaj, me pretendimin se zgjidhja e kontratës së punës është me shkak abuziv, pa shkaqe të arsyeshme, ka kërkuar zgjidhjen e pasojave ekonomike të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.4088 akti, datë 12.4.2010, ka rrëzuar kërkesën e palës së paditur për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit.

5.1. Gjykata, pasi citon nenet 42/2, 49 të Kushtetutës; pikën 3.d të marrëveshjes ekonomike dypalëshe, lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, miratuar me dekretin nr.224, datë 11.6.1992 të Presidentit të Republikës; kontratës së punës lidhur midis palëve ndërgjyqëse, nenet 36, 37/1 të Kodit të Procedurës Civile, arsyeton: “... përcaktimi paraprak i juridiksionit të një çështjeje që paraqitet për shqyrtim para gjykatave shqiptare ka gjetur rregullim të shprehur nëpërmjet një norme të ligjit të brendshëm (jus cogens). Përjashtimet nga rregullimi i mësipërm kërkohen në natyrën apo lëndën e mosmarrëveshjes (administrative apo kushtetuese) dhe, kur ka një element të huaj, në rastin më të mirë në aktet ndërkombëtare të pranuar nga palët (konventë apo marrëveshje dypalëshe), apo kërkohet në parimet e së drejtës ndërkombëtare, siç janë reciprociteti, ose norma të kolizionit... Marrëveshja e datës 10.6.1992 përbën një përcaktim të qartë mbrojtës nëpërmjet gëzimit të imunitetit për përgjegjësitë në raste të përcaktuara shprehimisht në të. Parimi që dhënia e imunitetit të subjekteve të caktuara të së drejtës përbën përjashtim nga juridiksioni i gjykatave të vendit në të cilin ngrihet çështja... Në rastin e ngritjes së pretendimit për imunitetin, në mënyrë të pashmangshme, gjykata verifikon, në radhë të parë, faktin nëse subjekti që paraqet pretendimin hyn nën sferën e mbrojtjes së parashikuar në aktin ndërkombëtar dhe së dyti, nëse sfera e të drejtave të reklamuar mbrohet nga akti. Ekzistenca e këtyre elementeve kërkohet në mënyrë kumulative dhe jo alternative, në aspektin që mungesa e njërit prej tyre e bën të paaplikueshëm normën. Në këtë këndvështrim, në pikën 3.d marrëveshja përcakton qartësisht subjektet që kanë imunitet dhe janë ato që: i) financohen; ii) kanë lidhur kontratë me Qeverinë Amerikane për të zbatuar sa flitet në marrëveshje, si dhe marrëveshja përcakton qartësisht sferën e gëzimit të imunitetit vetëm për përgjegjësitë civile që lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e këtyre punëve... Rezultoi nga gjykimi se pala e paditur (është), përfshihet në kategorinë e subjekteve që gëzojnë mbrojtjen nëpërmjet imunitetit që ofron marrëveshja,... Për sa i përket kushtit tjetër, marrëveshja në fjalë e kufizon sferën e mbrojtjes vetëm sa i përket përgjegjësisë civile që lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e këtyre punëve, duke lënë jashtë kësaj sfere llojet e tjera të përgjegjësisë, përfshirë këtu edhe të drejtat dhe detyrimet mes punëdhënësve dhe punëmarrësve të kompanisë... nga gjykata çmohet se një kontratë pune mes punëmarrësit dhe kompanisë nuk lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me përmbushjen e projektit... nga ana tjetër gjykata çmon se mosmarrëveshja e paraqitur për shqyrtim para saj është në juridiksionin gjyqësor pasi ajo është përcaktuar si e tillë në kontratën e lidhur dhe nënshkruar rregullisht mes palëve... vetë pala e paditur e ka përzgjedhur gjykatën... e ka pranuar faktin se kontrata e punës nuk është lidhur drejtpërdrejt me përmbushjen e detyrave siç përcakton marrëveshja”.

6. Kundër vendimit ka ushtruar ankim të veçantë ana e paditur: Chemonics International INC, me të cilin kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare.

7. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 27.5.2010, duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim dhe duke pasur parasysh se në praktikë kanë lindur keqkuptime lidhur me zbatimin e nenit 39 të Kodit të Procedurës Civile; me zbatimin e marrëveshjeve dypalëshe të nënshkruara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me qeveritë e vendeve të tjera, si dhe nga Konventa e Vjenës “Mbi marrëdhëniet diplomatike” (1961), konventa “Për privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara” dhe anekset e saj, miratuar me ligjin nr.9105, datë 17.7.2003, ka arritur në konkluzionin se është rasti të njësohet praktika gjyqësore lidhur me zbatimin e kësaj dispozite dhe marrëveshjeve dypalëshe.

7.1. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, për efekt të njësimi të praktikës gjyqësore, para Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë ka shtruar për diskutim këto çështje:

i) Kur midis subjekteve që gëzojnë imunitet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar (sipas konventës për privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara dhe anekset e saj, miratuar me ligjin nr.9105, datë 17.7.2003 dhe marrëveshjeve dypalëshe të lidhura midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të vendeve të tjera) janë lidhur kontrata punësimi me punëmarrës shqiptarë, a kanë gjykatat shqiptare juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga këto marrëdhënie pune?

ii) Nëse në kontratat e punësimi të lidhura midis subjekteve të mësipërme me cilësinë e punëdhënësve dhe punëmarrësve shqiptarë është përcaktuar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura për shkak të marrëdhënies së punës palët mund t'i drejtohen gjykatës shqiptare, a do të

konsiderohet një gjë e tillë si pranim vullnetar i juridiksionit shqiptar në kuptim të nenit 39/a të Kodit të Procedurës Civile?

Ligji i zbatueshëm

8. Dispozitat e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit të Punës dhe të marrëveshjes ekonomike dypalëshe, lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në të cilat është parashikuar:

8.1. Neni 42/2 i Kushtetutës: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.*

8.2. Neni 116 i Kushtetutës: *“1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.*

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre”.

8.3. Neni 122 i Kushtetutës: *“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.*

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj”.

8.4. Neni 39 i Kodit të Procedurës Civile: *“Anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, përveç kur: a) pranojnë vullnetarisht; b) ekzistojnë rastet dhe kushtet e parashikuara nga Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike”.*

8.5. Neni 7/3 i Kodi i Punës: *“Marrëveshjet që lidhen me juridiksionin janë të vlefshme vetëm nëse përcaktohen pas lindjes së konfliktit”.*

KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË VLERËSOJNË:

9. Të kufizohen për njësimin e praktikës gjyqësore vetëm për sa u përket mosmarrëveshjeve që lindin nga marrëdhëniet e punës midis punëmarrësve shqiptarë dhe subjekteve që gëzojnë imunitet juridiksional territorial sipas marrëveshjes dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, datë 10.6.1992, miratuar me dekretin nr.224, datë 11.6.1992 të Presidentit të Republikës. Kjo për arsye se interpretimi dhe zbatimi i tërësisë së akteve ndërkombëtare në të cilat parashikohet imuniteti juridiksional nga gjykatat shqiptare nuk është relevant me çështjen në shqyrtim dhe, njëkohësisht, mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi i këtyre akteve janë të dallueshme rast pas rasti dhe trajtimi njësuës i praktikës gjyqësore, referuar çështjes konkrete, mund të passjellë cenim të të drejtave qoftë të subjekteve që përfitojnë imunitet, apo të subjekteve, që për shkak të këtij imuniteti, u kufizohet aksesin në gjykatat shqiptare.

10. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në shqyrtim të akteve të dosjes gjyqësore, objektit të padisë, pretendimeve të palëve, vendimit të gjykatës, shkaqeve të ankimit dhe në interpretim e zbatim të dispozitave kushtetuese, të marrëveshjes dypalëshe të sipërcituar, të Kodit të Procedurës Civile, vlerësojnë se:

i) pretendimet e parashtruara në ankim, të cilat kanë të bëjnë me parimet e përgjithshme dhe që referojnë në pyetjen e parë të shtruar nga Kolegji Civil i kësaj gjykate për njësim të praktikës gjyqësore janë të drejta dhe si të tilla duhet të pranohen;

ii) ndërsa pretendimet që lidhen me rastin konkret e që referojnë në marrëveshjen dypalëshe të sipërcituar dhe në kontratën e punës lidhur midis palëve ndërgjyqëse nuk gjejnë mbështetje në ligj, prandaj nuk përbëjnë shkak ligjor për të motivuar cenimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

I-11. Në nenin 3.d të marrëveshjes shprehimisht parashikohet: *“Në mënyrë që t’i sigurojë përfitim maksimal popullsisë së Republikës së Shqipërisë, nga ndihma që do t’i jepet në bazë të kësaj marrëveshje dhe duke përjashtuar për sa mund të bihet dakord nga dyja qeveritë: d) Organizatat individuale, publike ose private dhe punonjësit e organizatave publike ose private, që kanë lidhur kontratë ose financohen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat ndodhen në Shqipëri për të vënë në zbatim sa flitet në këtë marrëveshje, do të kenë imunitet ndaj të gjitha përgjegjësive civile që lidhen drejtpërdrejt me përbushjen e këtyre punëve”*.

12. Në kuptim të përmbajtjes së kësaj dispozite, referuar akteve ndërkombëtare të miratuara nga shteti shqiptar, të tilla si Karta e OKB-së dhe Konventa mbi privilegjet dhe imunitetet e Kombeve të Bashkuara, Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike (e vitit 1961, hyrë në fuqi për Shqipërinë më 8.2.1998), Konventa e Vjenës për marrëdhëniet konsullore (1963), Konventa për privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara dhe anekset e saj, si dhe marrëveshjes dypalëshe të sipërcituar, është përcaktuar rrethi i subjekteve që janë të përjashtuar nga juridiksioni territorial i brendshëm gjyqësor dhe administrativ dhe, si pasojë, nuk mund të jenë subjekte të padive, kërkimeve apo procedurave të ekzekutimit në vendin tonë, sikurse është rasti. Përjashtimi nga juridiksioni territorial i vendit pritës, Shqipërisë, përfshin të gjitha funksionet zyrtare të këtyre subjekteve dhe është i paprekshëm, me përjashtim të rasti kur ata heqin dorë në mënyrë eksplicite.

12.1. Respektivisht, sipas pikës 3.d të kësaj marrëveshjeje, organizatat individuale, publike ose private, dhe punonjësit e organizatave publike ose private, që kanë kontratë me/ose financohen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që janë të pranishëm në Republikën e Shqipërisë për të kryer punë për sa flitet në këtë marrëveshje, do të kenë imunitet ndaj të gjitha përgjegjësive civile që lidhen direkt me kryerjen e këtyre punëve.

12.2. Për rastin konkret, rezulton se pala e paditur, Chemonics International INC, zyre përfaqësimi e Kompanisë Chemonics International INC, me qendër në shtetin Delaware të Shteteve të Bashkuara të Amerikës është zbatuese e programit II të Korpooratës Sfida e Mijëvjeçarit, me numër kontrate DFD-I-00-08-00070-00, projekt që financohet tërësisht nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Pra, si kontraktor që punon në Shqipëri për USAID-in, pala e paditur është subjekt i marrëveshjes së mësipërme. Për rrjedhojë, ky subjekt ka imunitet ndaj të gjitha përgjegjësive civile që lidhen me zbatimin e këtij projekti në Shqipëri.

13. Kolegjet e Bashkuara, në vështrim të nenit 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 6§1 të Konventës europiane të të drejtave të njeriut, jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, evidentojnë se e drejta e aksesit në gjykatën kombëtare u nënshtrohet rregullimeve kufizuese për aq sa këto kufizime nuk reduktojnë aksesin e individit në gjykatat kombëtare në një mënyrë të tillë, apo në atë masë sa të dëmtojë thelbin e të drejtës. Në kuptim të përmbajtjes së marrëveshjes konkrete dhe qëllimit legjitim të saj, nuk konstatohet asnjë lidhje e paarsyeshme e proporcionalitetit midis kufizimit në fjalë dhe qëllimit që synohet të arrihet prej saj.

14. Në këto rrethana, Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se, në dhënien e imunitetit palës së paditur në bazë të marrëveshjes dypalëshe, nuk mund të thuhet se është tejkaluar marzhi i vlerësimit që shtetit shqiptar i lejohet në kufizimin e aksesit të individit në gjykatë.

14.1. Ky qëndrim buron dhe nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, sipas së cilës *“... disa kufizime mbi aksesin (në gjykatë) duhet të konsiderohen si të qenësishme, si për shembull ato kufizime që përgjithësisht pranohen nga komuniteti i shteteve si pjesë e doktrinës së imunitetit shtetëror”*.¹

¹ MvElhinney kundër Irlandës ëGCJ, nr.31253/96, § 37, ECHR 2001-XI; Manoilescu dhe Dobrescu, (dec.), nr.60861/00, § 80, ECHR 2005-VI; Treska kundër Shqipërisë dhe Italisë (dec.), nr.26937/04, ECHR 2006; Vrioni e të tjerë kundër Shqipërisë dhe Italisë nr.35720/04 dhe 42832/06, § 44-47 ECHR 2009

15. Ndonëse nuk është i aplikueshëm në rastin konkret, i njëjti qëndrim mbahet dhe në nenin 31 të ligjit nr.3920, datë 21.11.1964 “Për të drejtat e të huajve dhe zbatimin e ligjit të huaj”, të ndryshuar, ku parashikohet se në lidhje me juridiksionin e gjykatave shqiptare ndaj të huajve dispozitat e këtij ligji “... nuk zbatohen kur me konventa ndërkombëtare, në të cilat ka marrë pjesë Republika Popullore e Shqipërisë, janë caktuar dispozita të ndryshme”.

16. Në vijim të argumentimit të mësipërm dhe në kushtet kur marrëveshja ndërkombëtare e mësipërme, që sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 116), ka një status superior ndaj ligjeve, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin njësoj se **kur midis subjekteve që gëzojnë imunitet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, sipas marrëveshjes dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës datë 10.6.1992, janë lidhur kontrata punësimi me punëmarrës shqiptarë, pavarësisht nga ligji i aplikueshëm për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, gjykatat shqiptare nuk kanë juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që mund të lindin nga këto marrëdhënie.**

II-17. Kolegjet e Bashkuara, duke marrë në konsideratë rrethanat e çështjes konkrete, veçanërisht kushteve të parashikuara në kontratën e punës lidhur midis palëve ndërgjyqëse, referuar nenit 32/2 të Konventës së Vjenës mbi marrëdhëniet diplomatike, nenit 39/a të Kodit të Procedurës Civile, vlerësojnë se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka rrëzuar kërkesën e palës së paditur duke pranuar juridiksionin gjyqësor shqiptar për shqyrtimin e kësaj çështje, është i drejtë dhe për këtë shkak duhet të lihet në fuqi.

18. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në lidhje me çështjen e dytë të shtruar për zgjidhje nga Kolegji Civil i po kësaj gjykate, vlerësojnë se për rastin në shqyrtim janë të qenësishëm faktorë ligjorë që formësojnë përjashtim nga rregullimet e mësipërme dhe që gjejnë mbështetje në germen “a” të nenit 39 të Kodit të Procedurës Civile dhe në nenin 32/2 të Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike (1961).

19. Ligji shqiptar dhe marrëveshjet ndërkombëtare ku shteti shqiptar është palë njohin dhe pranojnë se pavarësisht mungesës së juridiksionit të gjykatave shqiptare, për shkak të imunitetit që gëzon njëra prej palëve në mosmarrëveshje si subjekt i posaçëm parashikuar në një marrëveshje/konvente dy ose shumëpalëshe, çështja mund të hyjë në juridiksionin e gjykatave shqiptare në rast se pala heq dorë nga imuniteti.

20. Konventa e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike parashikon nocionin e heqjes dorë nga imuniteti për agjentët diplomatikë, anëtarët e familjes së tyre që jetojnë bashkërisht me ta, si dhe personelin teknik dhe administrativ të misionit, si dhe anëtarët e familjeve të tyre. Heqja dorë nga imuniteti, parashikuar në nenet 28 dhe 32 të Konventës në fjalë, i fut ata në juridiksionin e shtetit pritës. I njëjti parim dhe qëndrim konfirmohet edhe në nenin 39/a të Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu, ligji nr.3920 datë 21.11.1964 “Mbi gëzimin e të drejtave civile nga të huajt dhe zbatimin e ligjit të huaj” në nenin 30, a, parashikon se: “..... shtetasi ose personi juridik i huaj mund të paditet para gjykatave shqiptare: a) kur kur ka pranuar juridiksionin e gjykatave shqiptare.....”.

21. Pavarësisht se asnjë prej marrëveshjeve/ligjeve të mësipërme nuk përcakton formalisht aktin e heqjes dorë, të gjitha konvergojnë në atë se vetëm akti ku vullneti i subjektit për të hequr dorë nga imuniteti është shprehur qartë e fut çështjen në juridiksionin e gjykatave shqiptare.

22. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se pavarësisht se Marrëveshja ekonomike dypalëshe midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk parashikon shprehimisht heqjen dorë nga imuniteti, ky “emision” nuk sjell mosnjohjen e këtij parimi dhe aq më pak mosaplikimin e tij. Në të kundërt, siç rezulton në rastin konkret, palët e kanë pranuar mundësinë e heqjes dorë nga imuniteti që buron nga marrëveshja dhe e kanë aplikuar atë në lidhje me marrëdhëniet e punës, duke parashikuar shprehimisht në nenin XI kontratën e punës se: “Çdo mosmarrëveshje që lind nga ekzekutimi i kësaj kontrate që nuk do të zgjidhet në mënyrë miqësore do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Tiranë”.

23. Në këto rrethana, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se në kushtet kur pala e paditur Chemonics International INC ka përpiluar dhe nënshkruar një kontratë pune, e cila në mënyrë të qartë ka pranuar juridiksionin e një gjykate shqiptare për mosmarrëveshjet që mund të lindin midis palëve në kontratë, kjo përbën një shprehje të qartë të vullnetit të saj për heqjen dorë nga imuniteti që gëzon në bazë të marrëveshjes dypalëshe dhe nënshtrimin, vetëm për këtë lloj marrëdhënie juridiko civile, juridiksionit të gjykatave shqiptare.

24. Pavarësisht pretendimit se përcaktimi i juridiksionit në kontratën e punës është në kundërshtim me nenin 7/3 të Kodit të Punës, i cili parashikon se: *“Marrëveshjet që lidhen me juridiksionin janë të vlefshme vetëm nëse përcaktohen pas lindjes së konfliktit”*. Kolegjet e Bashkuara vlerësojnë se në rastin konkret nuk gjen zbatim dispozita e mësipërme. Dispozita që parashikon juridiksionin e gjykatave shqiptare në rastin konkret është pasojë e heqjes dorë nga imuniteti, gjë që përbën specifikë të veçantë dhe e dallon atë nga një marrëveshje për ndryshim juridiksioni në kuptim të dispozitës së mësipërme. Për më tepër, ky ndryshim, përveç se bëhet në favor të palës më vulnerabël në një kontratë punësimi, punëmarrësit, me qëllim rritjen e aksesit të tij në gjykatë duke rritur shkallën e garancive që ai gëzon në lidhje me zbatimin e kontratës, i shërben, gjithashtu, arritjes së një zgjidhjeje sa më të shpejtë e më të drejtë lidhur me mosmarrëveshjen, duke qenë kështu larg të qenit *“alteration in pejus”*.

25. Për gjithë sa më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin njësuës se *nëse në kontratat e punësimit të lidhura midis subjekteve të mësipërme me cilësinë e punëdhënësve dhe punëmarrësve shqiptarë është përcaktuar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura për shkak të marrëdhënies së punës palët mund t'i drejtohen gjykatës shqiptare, një gjë e tillë do të konsiderohet si pranimit vullnetar i juridiksionit të gjykatave shqiptare, në kuptim të nenit 39/a të Kodit të Procedurës Civile.*

26. Për sa më sipër, duke iu kthyer çështjes konkrete, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë vlerësojnë se vendimi nr.4088 Akti, datë 12.4.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 141/2 të Kushtetutës, të nenit 485, pika “a” të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të neneve 17, pika “a” dhe 1984 të ligjit nr.8588, datë 15.3.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSËN:

Lënen në fuqi të vendimit nr.4088 akti, datë 12.4.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Shpresa Beçaj (kryesuese) Ardian Dvorani, Gani Dizdari, Besnik Imeraj, Fatos Lulo, Arjana Fullani, Evelina Qirjako, Mirela Fana, Medi Bici

Anëtarë kundër: Ardian Nuni, Aleksandër Muskaj, Andi Çeliku, Majlinda Andrea, Guxim Zenelaj

MENDIMI I PAKICËS

1. Në gjyqtarët në pakicë, Ardian Nuni, Guxim Zenelaj, Andi Çeliku, Aleksandër Muskaj dhe Majlinda Andrea, kemi mendimin se vendimi nr.4088 akti, datë 12.4.2010 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me të cilin është rrëzuar kërkesa e palës së paditur për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare, është rrjedhojë e zbatimit të gabuar të ligjit dhe për këtë shkak Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhej të prishnin atë dhe, për mungesë të juridiksionit të gjykatave shqiptare, të vendosin pushimin e gjykimit të çështjes.

2. Në lidhje me çështjen e parë, që u përket rasteve kur midis subjekteve që gëzojnë imunitet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar (sipas marrëveshjes dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës datë 10.6.1992), janë lidhur kontrata punësimi me punëmarrës shqiptarë, pakica mban të njëjtin qëndrim me arsyetimin dhe përfundimin njësuës të arritur nga Kolegjet e Bashkuara, ndërsa për çështjen e dytë, lidhur me faktin se kur do të konsiderohet se është hequr dorë nga imuniteti juridiksional territorial, kemi mendim të ndryshëm.

2.1. Pakica vlerëson se në trajtimin dhe zgjidhjen e kësaj çështjeje nuk duhen anashkaluar rregullimet e bëra në aktet ndërkombëtare, Kodin e Procedurës Civile dhe atë të Punës. Zgjidhja e drejtë duhet parë në harmoni me të gjitha rregullimet e bëra në këto akte normative.

3. Referuar dispozitave kushtetuese, akteve ndërkombëtare të miratuara nga shteti shqiptar, marrëveshjes dypalëshe të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë me Qeverinë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, legjislacionit të punës dhe kontratës së punës, lidhur midis palëve ndërgjyqëse, pakica mendon se gjykatave shqiptare dhe për rastin konkret, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i mungon juridiksioni për të marrë në shqyrtim çështjen objekt gjykimi.

4. Midis qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës është lidhur Marrëveshja ekonomike dypalëshe, miratuar me dekretin nr.224, datë 11.6.1992 të Presidentit të Republikës.

4.1. Në pikën 3.d të marrëveshjes është parashikuar shprehimisht “*Në mënyrë që t’i sigurojë përfitim maksimal popullsisë së Republikës së Shqipërisë, nga ndihma që do t’i jepet në bazë të kësaj marrëveshjeje dhe duke përjashtuar për sa mund të bihet dakord nga dy qeveritë: d) Organizatat individuale, publike ose private dhe punonjësit e organizatave publike ose private, që kanë lidhur kontratë ose financohen nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat ndodhen në Shqipëri për të vënë në zbatim sa flitet në këtë marrëveshje, do të kenë imunitet ndaj të gjitha përgjegjësive civile që lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e këtyre punëve*”.

5. Është me vend të parashtrohet se përgjegjësia civile, si institut i së drejtës, kuptohet, së pari si përgjegjësi e dalluar nga ajo penale dhe, së dyti si përgjegjësi në të cilën përfshihen të gjitha kategoritë e tjera të përgjegjësive që rrjedhin nga cenimi ose mohimi i të drejtave kur ekzistojnë njëkohësisht të katër kushtet e kërkuara nga ligji (dëmi, faji, paligjshmëria e veprimit ose mosveprimit dhe lidhja shkakësore).

5.1. Në këtë kuptim, përgjegjësia civile është një koncept juridik më i gjerë, e cila përfshin edhe përgjegjësinë që lind për shkak të marrëdhënieve të punës.

6. Në pikën XII të kontratës së punës, lidhur midis paditëses Eriona Haxhiaj dhe palës së paditur Chemonics International INC, është përcaktuar se: “*Kjo kontratë lidhet sipas ligjit shqiptar dhe interpretimi, vlefshmëria do të kryhet në përputhje me ligjin shqiptar. Nëse kushtet dhe afatet e kësaj kontrate nuk janë parashikuar në këtë kontratë, do të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës*”, ndërsa në pikën XI parashikohet se: “*Çdo mosmarrëveshje që lind nga ekzekutimi i kësaj kontrate që nuk do të zgjidhet në mënyrë miqësore, do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Tiranë*”.

7. Në vështrim të përmbajtjes së pikës XI, palët kanë përcaktuar se për rregullimin e marrëdhënieve të punës, për të drejtat dhe detyrimet e palëve që lindin për shkak të kësaj marrëdhënie, si ligj të aplikueshëm, atë shqiptar.

8. Pala e paditur e këtij gjykimi përfshihet në kategorinë e atyre subjekteve që janë të përjashtuar nga juridiksioni territorial i brendshëm, gjyqësor dhe administrativ dhe për pasojë, *inter alia*, ajo nuk mund të jetë subjekt i padive, kërtimeve apo procedurave të ekzekutimit në vendin tonë, me përjashtim të rastit kur kjo palë heq dorë në mënyrë eksplicite.

9. Në çështjen objekt gjykimi është vënë në diskutim nëse parashikimi i bërë nga palët në pikën XI të kontratës së punës është ose jo heqje dorë nga imuniteti juridiksional territorial.

10. Sipas dispozitave të Konventës së Vjenës për marrëdhëniet diplomatike¹ dhe të Kodit të Procedurës Civile², heqja dorë nga imuniteti është në vullnetin e subjekteve që gëzojnë atë.

11. Në nenin 7/3 të Kodit të Punës është përcaktuar se “*Marrëveshjet që lidhen me juridiksionin janë të vlefshme vetëm nëse përcaktohen pas lindjes së konfliktit*”.

12. ***Në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, heqja dorë duhet të bëhet në mënyrë të shprehur (në mënyrë eksplicite) dhe pas lindjes së konfliktit.***

13. Gjithashtu, në kuptim të nenit 7/3 të Kodit të Punës, edhe nëse kjo klauzolë e kontratës së punës do të konsiderohej si heqje dorë nga imuniteti juridiksional territorial, në kushtet kur kjo marrëveshje është bërë para lindjes së konfliktit është e pavlefshme. Për rrjedhojë nuk mund të konsiderohet si heqje dorë nga imuniteti që pala e paditur gëzon nga marrëveshja dypalëshe e sipërcituar.

¹ Neni 32/2 “*Heqja dorë duhet të jetë gjithnjë e shprehur*”.

² Neni 39 i Kodit të Procedurës Civile: “*Anëtarët e përfaqësive diplomatike e konsullore të vendosura në Republikën e Shqipërisë nuk i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave shqiptare, përveç kur: a) pranojnë vullnetarisht*”.

14. Pakica rithekson se qëllimi i pikës 3 të nenit 7 të Kodit të Punës, për sa i takon marrëveshjes për juridiksion, është që të bëjë të pamundur që subjekteve përfitues të imunitetit juridiksional territorial t'u kufizohen këto të drejta në situata kur nuk ka konflikt, kur nuk ka mosmarrëveshje. Kjo dispozitë, e cila është ndaluese në objektin e saj, nuk mund të interpretohet me supozim të ndërsjellë, pasi privon këto subjekte nga të drejtat e njohura në aktet ndërkombëtare dhe/ose marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe.

14.1. Klauzola e kontratës së punës (pika XI), që vjen në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit, nuk krijon asnjë pasojë juridike për palët. Njëkohësisht ajo nuk mund të përdoret si mjet për të shmangur zbatimin e një norme juridike të caktuar në akte ndërkombëtare dhe/ose në marrëveshje dypalëshe apo shumëpalëshe.

14.2. Rregullimi ligjor i nenit 7/3 të Kodit të Punës nuk përbën kufizim të së drejtës për të hequr dorë nga imuniteti, por përcakton momentin se kur mund të hiqet dorë prej tij.

15. Në vijim të argumentit të parashtruar më lart dhe duke marrë në konsideratë në mënyrë koherente tërësinë e normave juridike që lidhen me këtë çështje, në opinionin tonë, duhej të ishte arritur në përfundimin njësuës se:

Në të gjitha rastet kur si palë e paditur para gjykatave shqiptare thirret një person fizik apo juridik që është subjekt i imunitetit juridiksional nga këto gjykata (sipas parashikimeve në akte ndërkombëtare ose në marrëveshje dy apo shumëpalëshe), heqja dorë nga ky imunitet mund të bëhet vetëm me akt në të cilin të shprehet në mënyrë të qartë vullneti për të hequr dorë dhe gjithnjë vetëm pas lindjes së konfliktit.

16. Për sa më sipër, në vështrimin e pakicës, në këtë çështje, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë duhej të prishnin vendimin nr.4088 Akti, datë 12.4.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe, për mungesë të juridiksionit të gjykatave shqiptare, të vendosin pushimin e gjykimit të çështjes.

Anëtarë: Andi Çeliku, Guxim Zenelaj, Ardian Nuni, Majlinda Andrea, Aleksandër Muskaj

MENDIM PARALEL

Ne, gjyqtarët Ardian Dvorani dhe Evelina Qirjako, bashkohemi me vendimin e shumicës së anëtarëve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë vetëm për sa i përket zgjidhjes që i kanë bërë këto Kolegje çështjes objekt gjykimi, duke vendosur:

“Lënien në fuqi të vendimit nr.4088 Akti, datë 12.4.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë”.

Por, në kushtet që nuk ndajmë të njëjtin mendim me shumicën e anëtarëve të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me shkaqet që kanë çuar në marrjen e këtij vendimi, pra me arsyetimin ligjor të vendimit, vlerësojmë të parashtrorjmë qëndrimin tonë në lidhje me pyetjet që u shtruan për diskutim para këtyre Kolegjeve.

Sic trajtohet në mënyrë të detajuar edhe në vendimin e Kolegjeve të Bashkuara nr.8, datë 31.5.2011, pyetjet që u shtruan për diskutim ishin:

1. *Kur midis subjekteve që gëzojnë imunitet nga juridiksioni shqiptar (sipas Konventës për privilegjet dhe imunitetet e agjencive të specializuara dhe anekset e saj, miratuar me ligjin nr.9105, datë 17.7.2003 dhe marrëveshjeve dypalëshe të lidhura midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverive të vendeve të tjera) janë lidhur kontrata punësimi me punëmarrës shqiptarë, a kanë gjykatat shqiptare juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga këto marrëdhënie pune.*

2. *Nëse në kontratat e punësimit të lidhura midis subjekteve të mësipërm me cilësinë e punëdhënësve dhe punëmarrësve shqiptarë është përcaktuar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura për shkak të marrëdhënies së punës palët mund t'i drejtohen gjykatës shqiptare, a do të konsiderohet një gjë e tillë si një pranim vullnetar i juridiksionit shqiptar në kuptim të nenit 39/a të Kodit të Procedurës Civile.*

Kolegjet e Bashkuara u kufizuan në unifikimin e praktikës gjyqësore vetëm të atyre mosmarrëveshjeve të cilat lindin nga marrëdhëniet e punës midis subjekteve që gëzojnë imunitet juridiksional territorial sipas marrëveshjes dypalëshe lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) të datës 10.6.1992, miratuar me dekretin nr.224, datë 11.6.1992 të Presidentit të Republikës dhe punëmarrësve shqiptarë.

Në gjykimin e kësaj çështjeje ka rezultuar e provuar se pikërisht ana e paditur, shoqëria Chemonics International INC është një zyrë përfaqësimi e kompanisë mëmë, Chemonics International INC, një shoqëri e të drejtës amerikane, themeluar sipas ligjit të përgjithshëm të shoqërive të shtetit Delaware. Zyra e përfaqësimit në Shqipëri është regjistruar me vendimin nr.36 546, datë 13.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në ushtrim të aktivitetit për zbatimin e projektit të reformës në administratën publike në Shqipëri kjo e fundit ka kontraktuar me USAID (organizatë amerikane e financuar prej Qeverisë së SHBA-së).

Vlerësojmë se për zgjidhjen e drejtë dhe në përputhje me ligjin të konfliktit objekt gjykimi në rradhë të parë duhet t'i referohemi dhe të analizojmë marrëveshjen dypalëshe të lidhur midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së SHBA-së të datës 10.6.1992, dhe krahas kësaj marrëveshje të analizohen dhe të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare që trajtojnë problemin e imunitetit juridiksional, si dhe ligjet e vendit.

Në analizë të kësaj marrëveshjeje, si dhe të akteve dhe parimeve të njohura ndërkombëtare, vlerësojmë se, në lidhje me konfliktin objekt gjykimi, ana e paditur nuk mund të ketë imunitet përpara juridiksionit gjyqësor shqiptar.

Arrijmë në këtë konkluzion pasi:

Në marrëveshjen dypalëshe të lidhur midis Qeverisë të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë të SHBA-së gjenden dy parashikime, të cilat flasin për imunitetin e palës së huaj nga juridiksioni gjyqësor i shtetit tjetër dhe konkretisht pika “d” dhe “e” e nenit 3 të kësaj marrëveshjeje.

Sipas shkronjës “e”, individët që janë shtetas amerikanë dhe që ushtrojnë funksionet përkatëse në zbatim të marrëveshjes, të cilët nuk janë anëtarë të misionit diplomatik (si dhe familjarët e tyre), gëzojnë imunitet “absolut” (në kuptim të akteve dhe parimeve të njohura të së drejtës ndërkombëtare) nga juridiksioni gjyqësor shqiptar, si për përgjegjësitë civile ashtu edhe ato penale, duke u barazuar statusi i tyre me atë të personelit të misionit diplomatik të SHBA-së në Shqipëri. Ky imunitet gjen zbatim për çdo lloj veprimi apo mosveprimi të tyre, të lidhur ose jo me kryerjen e detyrës (asistencës së dhënë në kuadër të bashkëpunimit ekonomik ç’ka është objekt i marrëveshjes dypalëshe), për të cilën ndodhen në Republikën e Shqipërisë.

Kjo kategori subjektsh nuk i nënshtrohet juridiksionit shqiptar dhe nuk ka asnjë kusht apo kufizim për gëzimin e imunitetit ndaj këtij juridiksioni, përveç kur ata pranojnë vullnetarisht juridiksionin apo autoritetet e një shteti të huaj dhe japin pëlqimin për një gjë të tillë. Ky parim i së drejtës ndërkombëtare gjen zbatim edhe në nenet 39 e 40 të Kodit të Procedurës Penale.

Përveç sa më sipër, në shkronjën “d” të pikës 3 të kësaj marrëveshjeje parashikohet që: *“Organizatata individuale, publike, ose private dhe punonjësit e organizatave publike ose private që kanë lidhur kontratë ose financohen nga qeveritë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat ndodhen në Shqipëri për të vënë në zbatim sa parashikohet në këtë marrëveshje, do të kenë imunitet ndaj të gjitha përgjegjësiave civile të lidhura drejtpërdrejt me përmbushjen e këtyre punëve”.*

Në analizë të këtij parashikimi, si dhe në referim të së drejtës ndërkombëtare publike, vlerësojmë se kjo kategori subjektsh gëzon imunitet “të kufizuar” nga juridiksioni gjyqësor shqiptar dhe këto subjekte do të kenë imunitet vetëm për ato veprime apo mosveprime, të cilat ndodhin/kryhen në kuadër të veprimtarisë së kryer prej tyre sipas marrëveshjes të cituar më lart, pra “të lidhura direkt” me përmbushjen e qëllimit dhe objektin e veprimtarisë së anës së paditur.

Ndryshe nga kategoria e subjekteve të përmendura në pikën “3/e”, këta individë e persona juridikë gëzojnë vetëm një shkallë të kufizuar imuniteti kundrejt juridiksionit gjyqësor shqiptar.

Në çështjen objekt gjykimi rezulton që paditësi ka parashtruar kërtime në lidhje me zgjidhjen e menjëhershme dhe të njëanshme të kontratës së punës të lidhur mes saj si punëmarrëse dhe të paditurit si punëdhënës.

Nga provat e administruara dhe të çmuara nga vetë gjykata e faktit është vërtetuar se i padituri bën pjesë në rrethin e subjekteve të parashikuara në shkronjën “d” të pikës 3 të marrëveshjes dypalëshe për sa kohë ajo është një shoqëri që ushtron aktivitet si nënkontraktore e USAID, e cila financohet nga Qeveria e SHBA-së.

Por ajo ç’ka pretendon ana e paditur nuk është gjë tjetër veçse mohim i të drejtës së paditësit për t’iu drejtuar gjykatës shqiptare dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjen që është krijuar mes tyre. Sa më sipër është krenjtësisht në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 142) dhe me Konventën europiane të të drejtave të njeriut (neni 6 dhe 1), si dhe shkelje e hapur e parimit të rëndësishëm të aksesit në gjykatë dhe e të drejtës për të pasur një proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm.

Pala e paditur, pavarësisht detyrimeve kontraktore të saj, dhe pavarësisht vullnetit të saj të shprehur në kontratë për të zgjidhur mosmarrëveshjet përpara një gjykate shqiptare, në një mënyrë jo proporcionale dhe pa treguar qëllimin e këtij veprimi, pa i siguruar palës tjetër një mjet efektiv ankimi për të fituar dhe rivendosur në vend të drejtën e saj të pretenduar të shkelur, kërkon që veprimet e saj të mos i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor të gjykatave shqiptare.

Në analizë të klauzolës 3/d të marrëveshjes së mësipërme arrijmë në përfundimin se me imunitet ndaj përgjegjësisë civile kuptohet fakti që ndaj këtyre subjekteve nuk mund të ngrihet padi civile përpara gjykatave shqiptare për rastet e parashikuara nga neni 3/d.

Neni 3/d ka parashikuar dy kushte kumulative që duhet të plotësohen në mënyrë që këto organizma të gëzojnë imunitet: i) subjekti të jetë një person fizik ose juridik, publik ose privat, që është kontraktuar ose financuar nga Qeveria e SHBA-së për kryerjen e punëve objekt i marrëveshjes, dhe ii) përgjegjësia civile të lidhet drejtpërdrejt me përmbushjen e këtyre punëve.

Rezulton që ana e paditur është person juridik i financuar dhe i kontraktuar nga Qeveria e SHBA-së për zbatimin në Shqipëri të *Programit të Reformës në Administratën Publike, në kuadër të Makroprojektit për Sfidën e Mijëvjeçarit*.

Ndërsa për sa i përket kushtit të dytë, vlerësojmë si ai nuk plotësohet, pasi jo çdo lloj veprimi juridiko-civil i kryer nga i padituri (aq më tepër lidhja e kontratave të punësimit me shtetas shqiptarë), përbën vetvetiu veprime “*të lidhura direkt*” me veprimtarinë e të paditurit në zbatim të marrëveshjes të cituar më lart. Kjo sepse qëllimi i marrëveshjes nuk është t’i japë të paditurit imunitet të pakufizuar për çdo lloj përgjegjësie civile, por vetëm për ato veprime që çmohen se janë në përmbushje direkte të objektit të veprimtarisë së tij.

Ky ka qenë edhe qëllimi i marrëveshjes, kur ka parashikuar se: “... *do të kenë imunitet ndaj të gjitha përgjegjësive civile që lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e këtyre punëve*”. Pra, qëllimi i marrëveshjes ka qenë t’iu japë këtyre subjekteve “imunitet të kufizuar”, duke e kufizuar këtë imunitet vetëm për përgjegjësinë civile që lidhet drejtpërdrejt me përmbushjen e punëve objekt i kësaj marrëveshjeje.

Për të kuptuar qartë këtë lloj imuniteti duhet të shikohet dhe qëllimi pse në këtë marrëveshje është bërë ky përjashtim. Kështu, qëllimi për të cilin është dhënë ky imunitet i kufizuar, del qartë në pjesën e parë të nenit 3, që thotë shprehimisht se: “*Në mënyrë që të sigurojë përfitimin maksimal për popullin e Republikës së Shqipërisë nga ndihma që do t’i jepet atij sipas kësaj marrëveshje dhe me përjashtim të rasteve kur qeveritë do të vendosin ndryshe....*”.

Në rast se do të interpretohej ndryshe kjo klauzolë atëherë çfarëdo kontraktues, jo nga ata që përfitojnë, por nga ata që i ofrojnë shërbime të paditurit, do të gjendeshin përpara pamundësisë për të mbrojtur interesat e tyre të ligjshme sipas kontratës, vetëm për shkak se pala tjetër është një subjekt i kontraktuar nga Qeveria e SHBA-së sipas kësaj marrëveshjeje. Një interpretim i tillë, në fakt do të barazonte të paditurin me kategorinë e subjekteve me imunitet absolut nga përgjegjësitë civile të treguara në pikën 3/e të marrëveshjes.

Vlerësojmë se në rast se edhe marrëdhënia e punës do të futej në ato përgjegjësi civile të cilat citon marrëveshja, atëherë ana e paditur do të kishte imunitet absolut dhe do të përjashtohet nga juridiksioni i shtetit shqiptar pavarësisht se e çfarë natyre ishte përgjegjësia civile, në një kohë që çmojmë se vetëm dhënia e asistencës teknike dhe cilësia e dhënies së saj janë objekt i përjashtuar si përgjegjësi civile, pasi janë të lidhura direkt me qëllimin dhe objektin e veprimtarisë së të paditurit.

Përveç sa më sipër, vlerësojmë se nëse imuniteti do të ishte i pakufizuar, pra, ana e paditur do të kishte imunitet absolut ndaj çdo lloj përgjegjësie civile, atëherë kjo gjë do të ishte në mënyrë të shprehur në këtë marrëveshje.

Prandaj jemi të mendimit se kontrata e punësimit, për vetë natyrën e saj, nuk bën pjesë në ato veprime që përfshihen në imunitetin e kufizuar që gëzon pala e paditur. Një kuptim dhe interpretim të tillë të drejtë të marrëveshjes, të parimeve e normave të së drejtës ndërkombëtare dhe të ligjit shqiptar, e gjejmë në vetë sjelljen e palës së paditur, e cila në kontratën e punësimit ka pranuar në mënyrë të shprehur edhe nënshtrimin ndaj juridiksionit gjyqësor shqiptar në rast konflikti midis tij dhe punëmarrësit.

Ne vlerësojmë se ky qëndrim i shprehur në kontratën e punës reflekton me korrektësi qëllimin dhe përmbajtjen e dispozitave të marrëveshjes, e cila nuk i përfshin marrëdhëniet e punës në veprimet e “*lidhura direkt*” me kryerjen e veprimtarive të ndihmës ekonomike të shtetit amerikan ndaj shtetit shqiptar.

Dispozitat e marrëveshjes dhe ato të kontratës së punës çmojmë se u përmbahen normave dhe parimeve të njohura të së drejtës ndërkombëtare lidhur me qëllimin dhe zbatimin e “*imunitetit të kufizuar*” nga juridiksioni; trajtimin e akteve sipas natyrës e qëllimit të tyre, duke pasur parasysh edhe se në këtë gjykim nuk jemi përpara një akti publik (*acta iure imperii*), por përpara një akti privat (*iure acta gestionis*) që nuk cenon sovranitetin e shtetit tjetër; garantimin e drejtësisë, barazisë, paanshmërisë dhe procesit të rregullt ligjor në çështje të lidhura me konflikte të zakonshme civile (sikurse janë ato të punësimit), duke parashikuar mjete ligjore shteruese të mbrojtjes për palët; garantimin e zbatimit të ligjit të vendit ku ushtrohet puna (*lex loci laboris*) dhe parimit të moscenimit të thelbit të mbrojtjes së punëmarrësit; parimit të ekskluzivitetit a përshtatshmërisë, reale e substanciale, të lidhjes së çështjes në konflikt me gjykatën e një shteti të caktuar; parimet e së drejtës ndërkombëtare për imunitet nga përgjegjësia civile në konfliktet e punës, vetëm nëse është vendosur imuniteti absolut, apo është parashikuar në mënyrë të shprehur në marrëveshje bilaterale imuniteti ndaj juridiksionit edhe për mosmarrëveshjet e punës etj.

Parimet e lartpërmendura të së drejtës ndërkombëtare përshkojnë dhe ligjin themeltar të shtetit tonë, Kushtetutën, dhe janë inkorporuar edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (nenet 37, 39, 40) dhe në Kodin e Punës (nenet 2, 3, 7 e vijues). Këto parime kanë qenë të njohura dhe janë parashikuar për t’u respektuar në mënyrë të shprehur nga vetë palët ndërgjyqëse në kontratën e punësimit të lidhur ndërmjet tyre, si për sa i përket ligjit të zbatueshëm, ashtu edhe juridiksionit të cilëve ata i nënshtrohen në rast mosmarrëveshjeje, juridiksionit gjyqësor shqiptar.

Në rast se do t’i bënim një interpretim të kundërt nga sa më sipër klauzolës së marrëveshjes, do të ndodheshim para një situatë ku interesat e palëve do të ishin dukshëm në raport joproporcional. Paditësi nuk do të dinte në cilën gjykatë të drejtohej dhe s’do të kishte asnjëherë mundësi efektive për të ushtruar të drejtën e padisë dhe për të rivendosur në vend të drejtat e shkelura. E kundërta ndodh me palën e paditur, e cila ka të gjithë mbrojtjen e duhur dhe të përshtatshme përpara gjykatave shqiptare.

Mbrojtja e parimeve themelore të cituara më lart ka gjetur zbatim dhe në një sërë vendimesh të GJEDNJ-së, qëndrimi i së cilës ka qenë në kufizimin e imunitetit shtetëror dhe zgjerimin e të drejtave të individit, duke i dhënë përparësi ushtrimit në mënyrë efektive të së drejtës së tyre për t’iu drejtuar gjykatës, si dhe një mbrojtje efektive të të drejtave të cenuara.

Ky qëndrim i GJEDNJ-së në lidhje me marrëdhëniet e punësimit dhe imunitetet e ushtruara nga ana e shteteve sipas Konventës së Vjenës, apo një marrëveshjeje ndërkombëtare, ka evoluar akoma më shumë në vendimet e saj të dhëna në vitin 2010 (*Cudak versus Lithuania, Vilho Eskelinen and other versus Finland*) etj., të cilat tregojnë se imuniteti absolut nuk ekziston, ai duhet të shqyrtohet rast pas rasti dhe se në çdo rast duhet t’i jepet përparësi të drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë, të ruhet parimi i proporcionalitetit, gjykimit nga një gjykatë e paanshme dhe zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor dhe brenda afateve të arsyeshme etj.

Në analizë të sa më sipër vlerësojmë se:

Për sa u përket përgjegjësive civile, të cilat nuk kanë lidhje direkte me objektin dhe qëllimin e veprimtarisë të anës së paditur (siç është në rastin konkret përgjegjësia civile që rrjedh nga konflikti i punës), kjo e fundit nuk mund të ketë imunitet përpara juridiksionit gjyqësor shqiptar.

Anëtarë: Evelina Qirjako, Ardian Dvorani

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 13.10.2011
Doli nga shtypi më 14.10.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë